

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6011  
E enjte, 27 shkurt 2020  
çmimi 0.40 €

## Adem Demaçi, veprimtari më unik që ka pasur Kosova

FAQE 7



Photo:Erkin Keçi - Anadolu Agency

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PUBLIKOHET LETËRKËMBIMI I ISH-KRYEMINISTRIT HASHIM THAÇI  
ME ISH-SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË NATO-S, ANDERS FOGH  
RASMUSSEN, RRETH FSK-SË NË VERI TË MITROVICËS

FAQE 4-5



# LETËRKËMBIMI THAÇI - RASMUSSEN PËR FSK-në NË VERI NGJALLË REAGIME NË VEND

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka cilësuar marrëveshje sekrete letërkëmbimin e ish-kryeministrit Hashim Thaçi me ish-sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, që FSK-ja të mos shkojë në veri pa njoftuar KFOR-in. Pasi e ka bërë publike këtë letërkëmbim, i cili ka ndodhur në prill të vitit 2013, ai ka

kërkuar që të dihet se kush ia kërkoi Thaçit zotimin për kufizimet territoriale për FSK-në. Sipas tij, fshehja e këtij letërkëmbimi paraqet shkelje flagrante të ish-kryeministrit të cilën duhet ta hetojë drejtësia. Publikimi i këtij letërkëmbimi nga ana e Kurtit ka nxituar reagime të shumta në vend. Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë

se është shqetësuese që për herë të parë një kryeministër i Kosovës i cilëson marrëveshjet me NATO-n në kundërshtim me interesat e Kosovës. Ndërkaq ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se e kishte njoftuar NATO-n për misionin e ri të FSK-së, ku zhvlehtësohen kufizimet territoriale në letërën e ish-kryeministrit Thaçi në vitin 2013

## Në Moskë, Rama i kërkon Lavrovit njohjen e pavarësisë së Kosovës

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në Moskë ka thënë se nuk ka arsye që të mos njihet Kosova shtet i pavarur. Në një konferencë të përbashkët për media me ministrin e Jashtëm të Rusisë, Sergey Lavrov, Rama ka thënë se me Lavrovin kanë diskutuar edhe për çështjen e Kosovës. "Po, diskutuam rreth kësaj dhe jemi shumë

larg sepse qëndrimi ynë është i qartë. Unë mendoj se është në të mirë të gjithkujt, edhe të Serbisë, që ta njohë Kosovën siç është", ka thënë Rama. Ndërkaq ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergey Lavrov, ka theksuar se Rusia do të pranojë çdo zgjidhje për Kosovën që është e pranueshme për Beogradin dhe Prishtinën



FAQE 2

### OPINION

PO KU JE O ADEM DEMAÇI  
QË TË KEMI HARRUAR SE KE  
JETUAR NDONJËHERË! F. 11

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



PËRKUJTIM PËR DITËLINDJE

F. 6

Shkruan: Jakup KRASNIQI

### AKTUALE

MIJËRA QYTETARË  
NË VIT HEQIN DORË NGA  
NËNSHTETËSIA E KOSOVËS F. 3

ENVER HOXHAJ: LAJÇAK,  
ZGJIDHJE E MIRË PËR EMISAR  
TË BE-SË PËR DIALOGUN F. 3

### EKONOMI

KOSOVA DO T'I TRAJTOJË  
ME PRIORITET PROJEKTET  
DHE MARRËVESHJET  
ME BANKËN BOTËRORE F. 9

MINISTRI MUSTAFA:  
SHOQATAT E FERMERËVE,  
PARTNERE KRYESORE TË  
MINISTRISË SË BUJQËSISË F. 8

### SPORT

APELI VËRTETON DËNIMIN ME  
BURG EFEKTIV PËR KRYETARIN E  
FFK-SË, AGIM ADEMI F. 16

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Ndahet nga jeta Nexhmije Hoxha, gruaja e ish-liderit Enver Hoxha

TIRANË, 26 SHKURT - Është ndarë nga jeta Nexhmije Hoxha, gruaja e ish-liderit Enver Hoxha, e cila gjurmën e fundit e la përmes një libri që ka dalë vetëm pak ditë më parë treg.

Nexhmije Hoxha, është ndarë nga jeta në moshën 99-vjeçare. Ajo u martua me Enver Hoxhën në janar të vitit 1945. Ata sollën në jetë tre fëmijë.

Nexhmije Hoxha ka qenë ish-drejtoreshë e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste pranë Komitetit Qendror të PPSH-së, presidente e Bashkimit të Grave

Antifashiste të Shqipërisë, përfaqësuese e popullit në Kuvendin Popullor, drejtoreshë e Drejtorisë së Propagandës, Arsimit dhe Kulturës në KQ të PPSH-së.



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka qëndruar të mërkurën për vizitë në Rusi

# Në Moskë, Rama i kërkon Lavrovit njohjen e pavarësisë së Kosovës

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në Moskë ka thënë se nuk ka arsye që të mos njihet Kosova shtet i pavarur. Në një konferencë të përbashkët për media me ministrin e Jashtëm të Rusisë, Sergey Lavrov, Rama ka thënë se me Lavrovin kanë diskutuar edhe për çështjen e Kosovës. "Po, diskutuam rreth kësaj dhe jemi shumë larg sepse qëndrimi ynë është i qartë. Unë mendoj se është në të mirë të gjithkujt, edhe të Serbisë, që ta njohë Kosovën siç është", ka thënë Rama. Ndërkaq ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergey Lavrov, ka theksuar se Rusia do të pranojë çdo zgjidhje për Kosovën që është e pranueshme për Beogradin dhe Prishtinën



PRISHTINË, 26 SHKURT - Ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergey Lavrov, ka thënë se Rusia do të pranojë çdo zgjidhje për Kosovën që është e pranueshme për Beogradin dhe Prishtinën. Ai i bëri këto komente në një konferencë për media me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, i cili po qëndron për vizitë në Moskë, në cilësinë e kryesuesit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Lavrov i kërkoj zbatimin e marrëveshjeve të arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me theks të veçantë atë për krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe, për moszbatimin e së cilës i fajësoi autoritetet e Prishtinës. "Ka një sërë marrëveshjesh të arritura ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, përfshirë krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe. Krijimi i Asociacionit do të ishte një hap më përpara për ta siguruar respektimin e të drejtave

të serbëve në Kosovë. Marrëveshja është arritur së paku gjashtë vjet më parë. Prishtina refuzon t'i respektojë detyrimet", tha Lavrov.

Shefi i diplomacisë ruse shprehu kritika edhe ndaj Bashkimit Evropian, që si ndërmjetës i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nuk ka arritur ta sigurojë zbatimin e marrëveshjeve. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, vuri theksin te qëndrimet e kundërta që kanë Shqipëria dhe Rusia për çështjen e Kosovës. Ai tha se procesi i dialogut duhet të riniset dhe se kur bëhet fjalë për marrëveshjet e arritura deri më tani, palët në vazhdimësi e kanë fajësuar njëra-tjetrën për moszbatimin e tyre.

Në konferencën e përbashkët për media Lavrov - Rama, i dërguari i "Top Channel" në Moskë, Muhamed Veliu, e pyeti shefin e diplomacisë ruse nëse ka shkaqe të reja përse Rusia vijon

mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës dhe nëse një ditë Moskë do ta njohë Kosovën si shtet? Edhe gazetari Muhamed Veliu e pyeti edhe kryeministrin Edi Rama nëse gjatë takimit me Lavrov i kishte kërkuar diçka specifike në lidhje me Kosovën. "Ju pyetët nëse unë mund të mendoj ndonjë datë kur Rusia do ta njohë Kosovën, është ajo çfarë përmendi Rama që duhet të ketë zbatim të asaj për çfarë bihet dakord. Ka një rezolutë 1244 që duhet zbatuar, që është miratuar dhe që ka një sërë marrëveshjesh mes dy vendeve, përfshirë krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë dhe krijimi i kësaj do të ishte një hap më para, për të siguruar të drejtat

e atyre serbëve që jetojnë në Kosovë. Marrëveshja është arritur së bashku 6 vjet më parë. Prishtina refuzon t'i respektojë detyrimet. E promovojmë dialogun, por kolegët tanë në BE nuk kanë arritur ta sigurojnë zbatimin e këtyre marrëveshjeve. Megjithatë, këmbëngul që kjo të zgjidhet në bazë të marrëveshjeve të miratuara", ka thënë Lavrov. Ndërsa Rama për të njëjtën gjë tha: "Po, diskutuam rreth kësaj dhe jemi shumë larg sepse qëndrimi ynë është i qartë. Unë mendoj se është në të mirë të gjithkujt, edhe të Serbisë, që ta njohë Kosovën siç është. Ne kemi mbështetur dialogun, pajtimin për ta arritur realizimin e kësaj njohje. Ka pasur shumë aspekte

të dialogut të materializuar në marrëveshje që nuk e kanë parë dritën e realizimit. I shpjegova Lavrovit se na duhet ta rinisim procesin. Unë besoj se palët e fajësojnë shumë njëri-tjetrin, por s'do t'i hyj kësaj. Unë do t'ia thosha ministrit opinionin tim, që vullneti i njerëzve nuk mund të jetë më standarde të dyfishta kur bëhet fjalë për të njohur ose për të mos njohur atë çka vullneti i njerëzve sjell në jetë për popullatat. Dhe për një popullatë si ajo e Kosovës që ka jetuar nën sundimin e një shteti që nuk e ka zgjedhur ajo, nuk e shoh pse të tjerët kanë të drejtën të ndahen e t'i kenë shtetet e tyre dhe Kosova jo. Megjithatë, ky është një kapitull tjetër", ka thënë Rama.

## Roth: Jam optimist për çeljen e negociatave me Shqipërinë

PRISHTINË, 26 SHKURT - Ministri gjerman për Evropën në Ministrinë e Jashtme gjermane, Michael Roth shprehet optimist për çeljen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Sipas agjencisë së lajmeve dpa, Roth shpreson, që në takimin e ardhshëm me homologët e tij më 24 mars "të jepet një sinjal i qartë në drejtim të Ballkanit

Perëndimor". Michael Roth ka kujtuar ndryshimet që janë bërë në metodologjinë e zgjerimit të BE-së dhe pret që Komisioni Evropian të njohë edhe progresin në reforma që kanë bërë të dyja vendet. Komisioni Evropian ka për të njohur "progresin e rëndësishëm" në drejtim të luftimit të korrupsionit dhe reformës së drejtësisë,

beson Roth. Vendimi për fillimin e negociatave me Shqipërinë e Maqedoninë e Veriut u shty në tetorin e vitit të kaluar, pas presionit të presidentit francez, Emmanuel Macron që kërkonte më parë reformimin e procesit të zgjerimit në BE. Tani Parisi është treguar i kënaqur me ndryshimet në procedurën e anëtarësimit të paraqitura

nga Komisioni Evropian. Por Parisi pret ende raportin e aktualizuar të progresit të Komisionit Evropian të planifikuar për publikim në fillim të marsit. Dihet se çelja e negociatave është vetëm fillimi i një procesi të gjatë disaveçar në anëtarësim. Vetëm nëse kandidatët i përmbushin kriteret dhe bëjnë reforma mund të anëtarësohen në fund në BE. E për



këtë nevojitet një vendim unanim i Bashkimit Evropian.

# Mijëra qytetarë në vit heqin dorë nga nënshtetësia e Kosovës

Më shumë se 5 000 qytetarë të Kosovës, sipas të dhënave zyrtare, kanë hequr dorë nga nënshtetësia e Kosovës vetëm në vitin 2019. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, qytetarët e Kosovës të cilët kanë hequr dorë nga nënshtetësia dhe kanë zgjedhur një nga shtetet e Bashkimit Evropian për ta marrë shtetësinë e re janë detyruar të ndërmarrin këtë veprim ngase disa shtete nuk e lejojnë dyshtetësinë

PRISHTINË, 26 SHKURT- Më shumë se pesë mijë qytetarë të Kosovës, sipas të dhënave zyrtare, kanë hequr dorë nga nënshtetësia e Kosovës vetëm në vitin 2019. Kjo shifër po konsiderohet shqetësuese pasi që nënkupton që këta persona nuk e shohin Kosovën më si shtet të tyre. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, qytet-

tarët e Kosovës të cilët kanë hequr dorë nga nënshtetësia dhe kanë zgjedhur një nga shtetet e Bashkimit Evropian për ta marrë shtetësinë e re janë detyruar të ndërmarrin këtë veprim ngase disa shtete nuk e lejojnë dyshtetësinë. "Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, në Divizionin e Shtetësisë janë marrë 5 461 vendime për lirim nga shtetësia. Prej tyre 5 394 janë

vendime pozitive, 67 vendime negative. Nënshtetësitë që marrin më së shumti qytetarët e Kosovës janë nënshtetësia gjermane, austriake, sllovene e të tjera", thuhet në të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.

Sipas të dhënave, mesatarisht në vit nga nënshtetësia e Kosovës janë liruuar më shumë se 5 000 mijë qytetarë. Trendi i lirim nga nënshtetësia ka shënuar ngritje nga viti 2014. Visar Xhambazi nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) thotë se nëse analizohen trendet ndër vite të heqjes dorë nga shtetësia e Kosovës, atëherë shihet se kemi rritje të kësaj dukurie, të cilën ai e quan shqetësuese. "Duhet të fokusohemi edhe te shkaku pse po largohen dhe pse po heqin dorë nga shtetësia e Kosovës këta qytetarë. Nëse i referohe-

mi statistikave të Bankës Botërore, sipas raporteve të tyre, papunësia te të rinjtë (në Kosovë) është diku rreth 50 për qind, derisa gjysma e popullsisë në Kosovë është nën moshën 30-vjeçare dhe trendi është i njëjtë në 5 vjetët e fundit. Po ashtu, nuk ka indikatorë që tregojnë se ky trend është duke u zvogëluar, prandaj shumë qytetarë, në veçanti të rinjtë, po e shohin si zgjidhje emigrimin nga Kosova dhe në momentin që ata e kanë mundësinë që të bëhen shtetas të ndonjë prej vendeve të BE-së, e bëjnë atë dhe heqin dorë nga shtetësia e Kosovës", thotë Xhambazi.

Ai shton se nëse analizohen të dhënat e heqjes dorë nga nënshtetësia e Kosovës nga viti 2014 - 2016, ka një trend të rritjes dhe atë për 20 për qind. "Nëse i marrim shifrat që nga viti 2009, një vit pas shpalljes

së pavarësisë, vërejmë që kemi një total prej 40 mijë qytetarëve të Kosovës që kanë hequr dorë nga nënshtetësia. Kjo nuk ndodhë vetëm në Kosovë, por edhe në vendet e rajonit", thotë ai.

Të dhënat ndër vite të Agjencisë së Statistikave të Kosovës kanë treguar për numër të madh të qytetarëve të cilët po e lëshojnë Kosovën. Në dekadën e fundit më shumë se 220 mijë qytetarë të Kosovës kanë lëshuar vendin.

Vendet ku qytetarët e Kosovës kanë emigruar më së shumti gjatë viteve 2010-2018 janë Gjermania, Franca, Austria, Kroacia e shtete të tjera.

Për periudhën 2016-2018, sipas një raporti të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, thuhet se Kosova ka humbur rreth 2 për qind të popullsisë së vendit. (REL)



## Enver Hoxhaj: Lajçak, zgjidhje e mirë për emisar të BE-së për dialogun

Prishtinë, 26 shkurt (ER) - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka thënë se emërimi i mundshëm i kryediplomatit sllovak Miroslav Lajçak nga BE-ja për dialogun Kosovë - Serbi është një zgjidhje e mirë. Hoxhaj ka thënë se Lajçak ka

mbështetur Kosovën dhe Ballkanin për dekada dhe ka një njohuri të jashtëzakonshme për secilin vend të rajonit. "Mirëpres emërimin potencial të Lajçak si përfaqësues special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi dhe për Ballkanin Perëndimor. Ai

ka mbështetur Kosovën dhe Ballkanin për dekada dhe ka njohuri të shkëlqyera për secilin shtet dhe rajonin. Ai është një zgjidhje e mirë për BE-në dhe Ballkanin Perëndimor", shkruan Hoxhaj në llogarinë e vet në "Twitter".





Publikohet letërkëmbimi i ish-kryeministrit Hashim Thaçi me ish-sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, rreth FSK-së në veri të Mitrovicës

# LETËRKËMBIMI THAÇI - RASMUSSEN PËR FSK-në NË VERI NGJALLË REAGIME NË VEND

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka cilësuar marrëveshje sekrete letërkëmbimin e ish-kryeministrit Hashim Thaçi me ish-sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, që FSK-ja të mos shkojë në veri pa njoftuar KFOR-in. Pasi e ka bërë publike këtë letërkëmbim, i cili ka ndodhur në prill të vitit 2013, ai ka kërkuar që të dihet se kush ia kërkoj Thaçit zotimin për kufizimet territoriale për FSK-në. Sipas tij, fshehja e këtij letërkëmbimi paraqet shkelje flagrante të ish-kryeministrit, të cilën duhet ta hetojë drejtësia. Publikimi i këtij letërkëmbimi nga ana e Kurtit ka nxituar reagime të shumta në vend. Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se është shqetësuese që për herë të parë një kryeministër i Kosovës i cilëson marrëveshjet me NATO-n në kundërshtim me interesat e Kosovës. Ndërkaq ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se kishte njoftuar NATO-n për misionin e ri të FSK-së, ku zhvlehtësohen kufizimet territoriale në letrën e ish-kryeministrit Thaçi në vitin 2013

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë publike të mërkurën letërkëmbimin e ish-kryeministrit Hashim Thaçi me ish-sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, në të cilën ish-shefi i qeverisë jep garanci se FSK-ja do të ndërmarrë misionin në veri të Kosovës vetëm në bashkëpunim me KFOR-in. Pasi për këtë letërkëmbim ka njoftuar

kryeparlamentaren Vjosa Osmani, Kurti ka mbajtur një konferencë të jashtëzakonshme për media, ku letërkëmbimin e ka cilësuar marrëveshje sekrete. Ai ka deklaruar se më 19 prill të vitit 2013 institucionet e Kosovës kanë qenë të informuara vetëm për një marrëveshje, atë me Serbinë, por jo edhe për letërkëmbimin në mes të Thaçit dhe NATO-s. "Atë ditë nuk kishim një, por dy marrëveshje në Bruksel. Njëra midis ish-kryeministrit Thaçi dhe ish-kryeministrit Daçiq e tjetra rreth

midis ish-sekretarit Rasmussen dhe ish-kryeministrit Thaçi, sipas opinionit ligjor të Zyrës së Kryeministrit, paraqet marrëveshje ndërkombëtare duke u bazuar në Konventën e Vjenës. Fshehja e një marrëveshjeje të tillë, e datës 19 prill 2013, konsiderojmë se është shkelje flagrante me të cilën duhet të merren organet e drejtësisë”, ka thënë Kurti.

Ai ka treguar se këtë letërkëmbim e ka siguruar nga një zyrtar i NATO-s në fund të vitit të kaluar. “Kjo marrëveshje, në të cilën shpiket togfjalëshi ‘Kosova veriore’ dhe thuhet se atje nuk do të shkojë FSK-ja pa pajtim paraprak me KFOR-in, që as nuk mori miratim paraprak nga institucionet e Kosovës dhe as më pastaj nuk u informua Kuvendi i Republikës së Kosovës, tregon në fakt se ‘Zajednica’ dhe shkëmbimi territorial nuk janë dy gjëra të ndryshme. Kjo marrëveshje tregon këtë gjë”, ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se tani i mbetet

Kuvendit që të ndërmarrë hapa të tjerë të nevojshëm, kurse si kryeministër nuk e ka ndërmend që t’i cenojë kompetencat e NATO-s, përkatësisht të KFOR-it në Kosovë. “FSK-ja, Ministria e Mbrojtjes, KFOR-i, NATO, janë gjithmonë bashkë në të njëjtën kohë”, ka deklaruar Kurti, duke treguar se të enjten (sot) do të takohet me komandantin e KFOR-it

### Reagojnë Veseli e Haradinaj

Ndaj publikimit të letërkëmbimit të Thaçit me Rasmussenin kanë reaguar ish-kryeparlamentari Kadri Veseli dhe ish-kryeministri Ramush Haradinaj.

Lideri i PDK-së ka shkruar në profilin e vet në “Facebook” se është shqetësues që për herë të parë një kryeministër i Kosovës i cilëson marrëveshjet me NATO-n në kundërshtim me interesat e Kosovës. “Është shqetësues fakti që për herë të parë një

## Çka përmban letërkëmbimi Thaçi - Rasmussen

Në letrën që ish-kryeministri Hashim Thaçi i ka dërguar ish-sekretarit të NATO-s në vitin 2013, ai është zotuar se FSK-ja do të ndërmarrë misionet në veri të Kosovës vetëm në bashkëpunim me KFOR-in. “Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës unë ju ofroj garanci se Forca e Sigurisë së Kosovës do të ketë mundësi të ndërmarrë misionet në veri të Kosovës vetëm në bashkëpunim me KFOR-in. Kjo është në përputhje të plotë me obligimet ekzistuese të Kosovës kundrejt NATO-s të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës i zbaton me seriozitetin më të madh. Qeveria e Republikës së Kosovës gjithashtu e ka të qartë, që KFOR-i, në përmbushjen e mandatit të tij,

mund të angazhohet me përfaqësuesit legjitimë të komunitetit lokal në veri të Kosovës, si pjesë e një procesi të rregullt bashkëpunimi”, thuhet në letrën që Thaçi i ka dërguar sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s.

Ndërsa ish-sekretari i NATO-s e ka pranuar zotimin e ish-kryeministrit dhe e ka falënderuar Thaçin për sigurinë e dhënë. “Faleminderit për letrën tuaj të datës 19 prill 2013! Unë e pranoj garancinë që ju po e ofroni që Forcat e Sigurisë së Kosovës do të ndërmarrin misionet në veri të Kosovës vetëm me pajtim paraprak nga misioni i NATO-s në Kosovë (KFOR-it)”, është thënë në përgjigjen e ish-sekretarit Rasmussen.

## Ish-komandanti i FSK-s, Kadri Kastrati: Kemi operuar edhe në veri

Për letërkëmbimin e Thaçit me Rasmussenin ka folur edhe ish-komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati. Ai ka treguar për “Epokën e re” se ka qenë në dijeni për këtë letërkëmbimin, por nuk e ka parë atë. “Unë letrën nuk e kam parë personalisht, por kam qenë në dije për ekzistimin e saj. Mirëpo si komandant i FSK-së atëherë kam qenë i detyruar që t’i zbatoj të gjitha urdhrat që vijnë nga institucionet qendrore për të shkruar në veri apo për të mos shkruar. Në atë kohë sa kam qenë komandant, FSK-ja ka operuar në veri dy herë në bashkëpunim me KFOR-in. Një herë për t’i kërkuar dhe gjetur dy serbë që kishin pasur një aksident në Liqenin e Ujkanit, herën e dytë kemi qenë në një operacion humanitar në bashkëpunim me KFOR-in. Pra, faktikisht në gjatë asaj kohe kemi operuar në veri”, ka thënë

Kastrati, duke e treguar qëllimin e letërkëmbimit. “Ajo marrëveshje ka qenë që FSK-ja të mos operojë e vetme pa KFOR-in në pjesën veriore. Pra, ka pasur për qëllim ta njoftojë KFOR-in për veprimet e veta dhe të veprojnë në bashkëpunim për shkak të situatës. Unë asnjëherë nuk kam pasur ndalesa prej institucioneve qendrore që të mos veprojnë në veri të vendit”, ka thënë Kastrati. Sipas tij, kjo garanci nuk duhet të vlejë prej ndërrimit të misionit të FSK-së. “Me mandatin e ri ushtarak që ka marrë FSK-ja, mendoj se ushtria e Kosovës nuk duhet të ketë kufizime. Ajo duhet të veprojnë në të gjithë territorin e Kosovës. Bazuar në misionin që ka, kjo forcë ka për detyrë mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës”, është shprehur Kastrati.

kryeministër i Kosovës i cilëson marrëveshjet me NATO-n në kundërshtim me interesat e Kosovës. Gjatë luftës sonë çlirimtare kam qenë vetë dëshmitar i veprimeve të kësaj Aleance, e prire nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bashkë me ne, në interes të Kosovës, çlirimit të vendit tonë dhe kthimit të qindra mijëra qytetarëve të Kosovës në shtëpitë e tyre”, ka shkruar Veseli.

Ai ka shtuar se sovraniteti i Kosovës nuk rrezikohet nga NATO, por nga Serbia. “Qëllimi ynë është anëtarësimi në NATO dhe jo largimi i tyre nga cilido cep i Kosovës. Sot sovraniteti i Kosovës nuk rrezikohet nga NATO dhe marrëveshjet me NATO-n, por nga agresiviteti dhe kërcënimet e Serbisë. NATO është garanci e sovranitetit dhe integritetit të Kosovës”, ka shkruar ai.

Ndërsa ish-kryeministri Ramush Haradinaj, në kohën e të cilit është bërë transformimi i FSK-së në ushtri, ka treguar se e ka njoftuar NATO-n për misionin e ri të FSK-së, duke kërkuar heqjen

e kufizimeve që ishin vendosur përmes letrës së Thaçit. “Pas punës maratonike të sigurimit të mbështetjes së ShBA-së e partnerëve kryesorë brenda NATO-s si dhe të parapërgatitjes e dërgimit të 3 ligjeve për transformimin e FSK-së në ushtri për votim në Kuvendin e Kosovës, më 9 janar 2019 kam shkruar edhe këtë letër drejtuar sekretarit të NATO-s, Jens Stoltenberg, në të cilën e njoftoj për mandatin historik të transformimit të FSK-së si forcë shumetnike e profesionale në Ushtri të Kosovës, duke e falënderuar për bashkëpunimin e misionin 20-vjeçar në sigurimin e ruajtjes dhe paqes në Kosovë. Qëllimi i letrës ishte të njoftohet se pas votimit të ligjeve në Kuvend, zhvlehtësohen kufizimet territoriale në letrën e ish-kryeministrit Thaçi në vitin 2013 dhe i bëj ftesë NATO-s që përmes KFOR-it të nënshkruajmë protokoll të ri të bashkëpunimit operacional, këtë herë pa kufizime territoriale”, ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në “Facebook”.

Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila pa pajtim paraprak nuk do të shkonte në Kosovën Veriore”, ka thënë Kurti. Ai ka bërë me dije se për qeverinë është me rëndësi të dihet se kush ia ka kërkuar këtë zotim ish-kryeministrit. Sipas tij, fshehja e kësaj marrëveshjeje nga deputetët paraqet shkelje flagrante, për të cilat duhet të merret drejtësia. “Të marrim vesh kush e ka kërkuar që FSK-ja mos të shkojë në Kosovën Veriore, nuk besoj se Brukseli e ka kërkuar. Mund t’ia ketë kërkuar Serbia, por kjo duhet të dihet. Ky shkëmbim i letrave

## Bajrami dhe Barishiq bisedojnë rreth mësimit të gjuhës kroate në Universitetin e Prishtinës

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Kroacisë në Kosovë, Danijela Barishiq, me të cilën ka biseduar për bashkëpunimin mes dy vendeve në fushën e arsimit. Ambasadorja Barishiq i ka uruar detyrën ministres Bajrami, ndërsa ka theksuar se Kroacia mbetet e përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve në arsim. Ministrja

Bajrami falënderoi ambasadorin për mbështetje, ndërsa theksoi rëndësinë që ka për Kosovën bashkëpunimi me Kroacinë në të gjithë sektorët, e veçanërisht në atë të arsimit. Ajo e informoi ambasadorin Barishiq për gjendjen në arsim në vendin tonë dhe programin qeverisës që synon përmirësimin e gjendjes. Në takim, ndër të tjera, u bisedua edhe rreth mësimit të gjuhës kroate në Universitetin e Prishtinës, përkatësisht të gjuhës shqipe në Universitetin e Zagrebit.



Adem Demaçi, 26 shkurt 1936

# PËRKUJTIM PËR DITËLINDJE

**Shkruan: Jakup KRASNIQI**

Adem Demaçi si edhe shumë mendje të ndritura të kombit tonë, që në këtë rast do t'i veçoja Rexhep Qosjen e Ismail Kadarenë, lindën në vitet 1935/36 të shekullit XX, lindën në mjegullën e një furtune të madhe, mbase më të madhe në historinë e përbotshme, siç që Lufta e Dytë Botërore. Adem Demaçi lindi, siç thotë e ëma, Nazifja, në gusht/shtator 1935, por u regjistrua nga i ati, Zeqiri, më 26 shkurt 1936.

Adem Demaçi ishte personalitet me vizion e integritet, me dinjitet e ndershmëri politike e kombëtare. Edhe bota të tillë personalitete i ka të paktë. Një jetë të tillë politike e patriotike Adem Demaçi e bëri dhe e nisi që nga bankat e shkollës fillore (1942), kur mësueses ia bëri pyetjen: "Mësuese, përse shqiptonja në flamurin tonë është e rrethuar me sëpata?" Askush nuk mund të thotë se kjo pyetje nuk ishte politike e një çuni gjashtë-shtatëvjeçar? Pra, Adem Demaçi që në vitin e parë të shkollës fillore (6/7-vjeçar) kërkonte çlirimin e shqiptonjës nga sëpatat e Liktorit, ndërsa mësuesja me lot në sy i premtojte: "Edhe pak kohë shqiptonja jonë ka për t'i luajtur krahët e vet të fuqishëm dhe ka për t'i bërë copë e grimë sëpatat e zeza fashiste!" Po çlirimi i shqiptonjës nuk do të vinte vetë. U desh lufta e armatosur katërvjeçare, u desh gjaku e jeta e 28 000 shqiptarëve - dëshmorë të Shqipërisë dhe të dhjetëra mijëra të Kosovës e të trevave të tjera shqiptare, që të çlirohej shqiptonja nga sëpatat e liktorit që aq shumë e donte dhe e priste Adem Demaçi - fëmijë. Dhe kjo dashuri nuk iu

zvetënua kurrë, përkundrazi u brumos deri në pakufi. Dashuri që i dha dekada të vështira jete në kazamatet serbe. Ai ishte paralajmërimi i parë se Adem Demaçi kishte një dashuri të veçantë për kombin dhe atdheun, për çlirimin dhe bashkimin kombëtar. Ishte paralajmërim se Ai do të kishte një rrugë të veçantë nëpër të cilën do të ecte me dashuri, guxim e vendosmëri, me përkushtim e integritet të rrallë njerëzor për t'u bërë bashkë me Nënë e Tij - Shqipërinë. Në atë rrugë asnjëri nga bashkëveprimtarët e tij nuk qe konsekuent si ai. A nuk e bënë atë të veçantë? Me diçka shumë të rrallë. Po! Këtë dashuri ia kishte dhënë, edhe ia kishte ngulitur në mendje e zemër që në fëmijëri, bile dhe ia kishte lënë amanet Nëna Nazife. "Se Nëna vdes, por populli nuk vdes kurrë", i thoshte ajo! Pra, Nënë Nazifja ishte ajo që ia ushqej dashurinë djalit të vetëm të saj për kombin dhe atdheun! Se i edukojnë dhe ua mbjellin nënat e kohës sonë fëmijëve të tyre këtë dashuri, unë nuk mund të pohoj me siguri! Natyrisht, do të doja të flisja sot para jush me siguri?!

Adem Demaçi integritetin politik e nisi hapur para 60 vjetëve, saktësisht në vitin 1958. Pas daljes nga burgu i parë ai me shumë veprimtarë politikë, formuan organizatën politike, Lëvizjen Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (1963), e pastaj u burgos për të dytën herë më 1964 dhe mbajti dhjetë vjet burgu, u lirua më 1974. Armiku nuk dëshironte ta shihte atë në liri dhe e burgosin për të tretën më 1975, nga i cili burg lirohet në prill të vitit 1990. Pra, Adem Demaçi në burgjet e Jugosllavisë i jetoj 28 vjet. Demaçi politikës për



bashkimin e kombit e të atdheut nuk iu nda asnjëherë, krejt deri më 26 korrik 2018. Adem Demaçi ishte lider si atëherë kur ishte prapa grilave, si atëherë kur nuk ishte në vendin e tij të robëruar, por shqiptarët i orientonte për çlirim e bashkim ideali i tij. Duhet ta themi me dhimbje, shqiptarët se ndoqën liderin e lindur pas daljes nga burgu në vitin 1990, idealistin e panënshtuar, ndoshta kjo bëri që diku ta humbasim hapin e zhvillimit dhe të shtetndërtimit pas luftës çlirimtare. Ne shqiptarët, sot më shumë se dje kemi nevojë për një

personalitet konsekuent, konsistent e koherent, me shumë integritet, ashtu siç e kishim dhe ishte Adem Demaçi.

Adem Demaçi për veprimtarinë e tij jetësore, për qëndresën e veçantë, për humanizmin e tij për njeriun në përgjithësi, mori shumë çmime vendore e ndërkombëtare, me të cilat është nderuar vepra dhe sakrificat e pashembullt e tij, për njeriun dhe të drejtat njerëzore. E vërteta është se ato çmime janë të varfra për t'i dhënë vendin e merituar njeriut që bëri shumë për kombin e tij,

duke sakrifikuar shumë nga jeta njerëzore dhe familjare. Njeriut që për asnjë moment nuk e ngarkoi shpirtin njerëzor me helm e urrejtjes, helm që e kishin me bollëk kundërshtarët e tij politikë në ambientin shqiptar e ballkanas! Armiqtë e idealit të tij politik nuk pushuan asnjëherë luftën ndaj personalitetit të tij. Mbase nuk e pushojnë as sot! Adem Demaçi nuk kishte armiq personalë, por ishte vepra e tij, ideali i tij që i kishte lënë ata nën hijen e lisit të madh të kombit dhe dëshironin të dilnin dhe dolën në dritë me çejzin e huaj politik.

## Manxhuka: Lajmi për vdekjen e prof. Safet Beqirit ishte i hidhur për Dekanatin e Mjekësisë

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Në Dekanatin e Fakultetit të Mjekësisë është mbajtur mbledhje përkujtimore për ta përkujtuar punën dhe veprimtarinë profesionale e shkencore të profesor Safet Beqiri.

Profesorë, miq, kolegë dhe bashkëpunëtorë kanë përkujtuar figurën e profesorit që gjithë jetën ua përkushtoi pacientëve dhe studentëve. Duke folur në këtë mbledhje përkujtimore, dekanja e Fakultetit të Mjekësisë, Suzana Manxhuka-Kërliu, kujtoi veprën dhe jetën e Beqirit, derisa tha se



nuk ka humbur vetëm familja, por gjithë Dekanati i Mjekësisë dhe Kirurgjia Torakale. "Lajmi për vdekjen e hershme ishte një lajm i hidhur për Dekanatin e Mjekësisë. Ka marrë pjesë në shumë simpoziume dhe ishte anëtar i shumë organizatave. Kisha nderin të punoja me Safetin, i afërt, i sinqertë dhe një humanist dhe profesionist i çmuar", ka thënë Manxhuka.

Drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Basri Sejdiu, ka theksuar se profesori kishte për qëllim ngritjen e

institucioneve të Kosovës. Ai e quajti atë ambasador të Kosovës në Gjermani. "Puna dhe vepra e humanistit dhe profesionistit na bën krenar. Kishte për qëllim ngritjen e institucioneve. Dijen e tij e kanë absorbuar të gjithë kolegët dhe studentët", është shprehur Sejdiu.

Për punën dhe kujtimet me prof. Beqirin folën edhe kolegët nga Gjermania, Eckvard Mayer dhe Servet Bolukbash, të cilët thanë se ai nuk e harroi asnjëherë vendlindjen e tij, ishte humanist dhe profesionist i mirë.

Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” është hapur ekspozita “Kujtesa e Kosovës, portrete të Adem Demaçit në pikturë dhe fotografi”

## Adem Demaçi, veprimtari më unik që ka pasur Kosova

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë të mërkurën në hapjen e ekspozitës “Kujtesa e Kosovës, portrete të Adem Demaçit në pikturë dhe fotografi”, hapur me rastin e 84-vjetorit të lindjes së Adem Demaçit. Me këtë rast, Kurti ka pohuar se Baca Adem gjithë jetën i kushtoi idealit të kombit shqiptar tek i cili ai e gjente vetveten dhe të vërtetën. “Baca Adem e kuptonte se përtej dallimeve që ne kishim, kishte diçka që na bashkonte, e kjo ishte edhe të qenit shqiptar, edhe njerëz lirishtës”, ka thënë Kurti

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 SHKURT - Me rastin e 84-vjetorit të lindjes së veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçit, Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” dhe Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës kanë hapur të mërkurën ekspozitën me temë “Kujtesa e Kosovës, portrete të Adem Demaçit në pikturë dhe fotografi”.

Pjesëmarrës në ceremoninë e hapjes së kësaj ekspozite kanë qenë edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, përfaqësues të Shoqatës së të Burgosurve Politikë, familjarë të Demaçit si dhe bashkëpunëtorë të tij.

Kryeministri Kurti ka thënë se Baca Adem i kushtoi gjithë jetën idealit të kombit shqiptar tek i cili ai e gjente vetveten dhe të vërtetën. “Faleminderit që më keni ftuar të flas sot në këtë ekspozitë që vjen për nder të ditëlindjes së Adem Demaçit, atij më meritortit e më të devotshmit, atdhetarit e lirishtës, patriotit e intelektualit me të cilin jemi të rrethuar në këtë ekspozitë përmes pikturave dhe fotografive të tij. Baca Adem

është veprimtari më unik që kemi pasur sepse është veprimtari më autentik që mund ta imagjinoi. Jetën e tij ai e kuptonte si shërbim për popullin shqiptar dhe nuk kishte shpërputhje midis mendimit dhe fjalës dhe sjelljes dhe veprimit. Ishte i njëjti gjithmonë Baca Adem, në çdo situatë, tërë kohën”, ka thënë Kurti. Ai ka



shtuar se kur nuk kishin shkolla shqiptarët, Adem Demaçi ishte mësuesi; kur nuk kishin universitet, ishte intelektual i tyre, e kur nuk kishin ushtri, ai ishte luftëtar. “Kur ishim të shpërndarë ai na bënte bashkë, e kur harronim, ai na rikujtonte, prandaj kjo ekspozitë vjen si freskim i kujtesës për të, por

edhe rikujtim e reflektim për veten tonë, për punën dhe rrugëtimin tonë të përbashkët. Baca Adem i kushtoj gjithë jetën e tij idealit të kombit shqiptar tek i cili ai e gjente edhe vetveten dhe të vërtetën. Baca Adem e kuptonte se përtej dallimeve që ne kishim, kishte diçka që na bashkonte, e kjo ishte edhe të qenit shqiptar, edhe njerëz lirishtës. Ai e kuptonte se çfarëdo që ne mund të arrinim vetëm, vetëm të bashkuar mund t'i arrinim qëllimet e përbashkëta”, ka thënë ai. Kryeministri Kurti ka shtuar se bashkimin tonë Baca Adem kurrë nuk e shihte kundërshtues ose kundër dikujt tjetër. “Gjithmonë e shihte për të mirën e përbashkët, pa dallime, pa diskriminim, pa favorizime, pa privilegje, dhe këtë e bënte në një rrafsh universal. Bashkimin tonë ua dëshironte edhe të tjerëve. Pra, nuk përçante të tjetër për të na bashkuar neve, por na bashkonte neve për veten tonë e kundër askujt tjetër. Adem Demaçi ishte vetëmohim me paramendim. Ai e dinte që

populli i shtypur ekziston për aq sa reziston. Filloi si gazetar, shkrimtar dhe intelektual i ri, disidenti më emblematik i gjithë Evropës Lindore, e kulmoi si përfaqësues i përgjithshëm politik i UÇK-së”, është shprehur Kurti, duke shtuar se Adem Demaçi nuk i mohonte të arriturat e të tjerëve mirëpo, sipas tij, vinte theksin tek ajo që ende ngelet e përcaktuar. “Nuk kënaqej me pak, sepse gjithmonë besonte se meritohet më shumë. Unë nuk mund të them se di më shumë se të tjerët për Bacën Adem, apo se e kam njohur më mirë dhe e kam dashur më shumë se të tjerët, por ajo që di është se ndiej një falënderim të veçantë për njeriun pa të cilin rrugëtimi im do të ishte i pamundur. Baca Adem është tallur me vdekjen dhe i ka buzëqeshur rrezikut. I qëndrueshëm përtej çfarëdo përfytyrimi dhe frymëzues jashtë cilësdo vetëdije. Adem Demaçi ka jetuar gjatë dhe shumë, i tillë do të jetë edhe ndikimi i tij: i gjatë në ardhmëri dhe i shumë të ndër brezat që do të vijnë. Si

kryeministër i Republikës së Kosovës, bashkë me ministren tonë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ne zotohemi se do të përkujdesemi për botimin dhe shpërndarjen e veprës së plotë të Bacës Adem, të Adem Demaçit. Ai na e ka lënë mësim jetën e tij, por ka lënë edhe shumë vepra të shkruara të cilat janë aq të rëndësishme për jetën tonë dhe gjeneratat që vijnë”, është shprehur kryeministri Kurti. Ndërsa Selatin Novosella nga Shoqata e të Burgosurve Politikë ka thënë se kur të na zbehet dashuria për atdheun duhet ta kujtojmë Adem Demaçin. “Sa herë të na zbehet dashuria për atdheun do ta kujtojmë bacën Adem. Brezat duhet të mësojnë për Adem Demaçin. Shumica e njerëzve vdesin, por ai duhet të jetë pjesë e jetës sonë”, është shprehur Novosella.

Veprimtari i çështjes kombëtare, Adem Demaçi, ka ndërruar jetë më 26 korrik në vitin 2018. Ai ishte personaliteti shqiptar që vuajti dënimin më të gjatë në ish-Jugosllavi, në mbrojtje të çështjes kombëtare shqiptare.



# Një delegacion i kryetarëve të komunave nga Kosova po qëndron në shtetin amerikan të Iowas

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Partneriteti ndërmjet Kosovës dhe Iowas do të vazhdojë të fuqizohet përmes bashkëpunimit më të afërt ndërmjet autoriteteve lokale të të dyja shteteve, por edhe duke u zgjeruar me bashkëpunimin ekonomik. Kështu u konkludua gjatë një takimi të zëvendës guvernatorit të shtetit amerikan të Iowas me një delegacion të kryetarëve të

komunave të Republikës së Kosovës, të cilët po qëndrojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nën organizimin e Agjencisë për Zhvillim Rajonal - Qendër dhe Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Zëvendës guvernatori i Shtetit të Iowas, Adam Gregg, u shpreh i lumtur me partneritetin e Iowas me Kosovën, i cili reflektohet përmes marrëveshjeve të partneritetit ndërmjet qyteteve të

ndryshme të Kosovës me ato të Iowas. Ai shprehu zotimin e shtetit të tij për zgjerimin e këtij partneriteti edhe në fushën e ekonomisë, duke theksuar mundësinë që biznese nga Iowa të bëhen pjesë e delegacionit të guvernatores së Iowas gjatë vizitës së saj në Kosovë në muajin qershor.

Sipas njoftimit për media të Odës Ekonomike Amerikane, pjesë e këtij delegacioni ishin kryetari i

Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, kryetari i Komunës së Ranillugut, Vladica Artonoviç, kryetari i Komunës së Mamushës, Abdulhadi Krasnic, kryetari i Komunës së Parteshit, Dragan Petkoviç, dy drejtorë

komunalë nga Komuna e Graçanicës, Milos Dimitrijeviç dhe Dejan Jovanoviç, si dhe Blerim Hasani, përfaqësues i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. Kryetarët e komunave të Kosovës shprehën zotimin e tyre për fuqizim të partneritetit me qytetet përkatëse nga shteti i Iowas, duke prezantuar, mes të tjerash, edhe mundësitë për investime në komunat e tyre për kompanitë amerikane nga Iowa.



## Ministri Mustafa: Shoqatat e fermerëve, partnere kryesore të Ministrisë së Bujqësisë

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Shoqatat Bujqësore të Kosovës do të jenë partnere kryesore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në hartimin dhe zbatimin e të gjitha politikave mbështetëse për fermerët dhe përpunuesit në të gjithë sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Konfirmimin për këtë e ka dhënë të mërkurën ministri i MBPZHR-së, Besian Mustafa, gjatë takimit që ka pasur me përfaqësuesit e Shoqatave Bujqësore të Kosovës në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës. Ministri Mustafa gjatë këtij takimi ka diskutuar me shoqatat rreth programeve mbështetëse të ministrisë, me ç'rast i ka njoftuar ata edhe me prioritetet në këtë



mandat që, sipas tij, në fokus do ta kenë zhvillimin dhe avancimin e veprimtarive bujqësore të fermerëve në gjithë vendin. "Jemi duke punuar me shumë përkushtim që në këto programe mbështetëse ta bëjmë riorganizimin e subvencioneve prej sipërfaqes drejt sasisë dhe

cilësisë të prodhuar dhe në këto programe do të përqipemi që t'i zgjerojmë mundësitë e investimeve duke vendosur kritere të mirëfillta", ka thënë ministri Mustafa.

Ndër të tjera, ai ka theksuar se do të vazhdojnë të jenë transparentë në çdo fazë të procesit që ndërlihet

me zbatimin e këtij programi, që nga vlerësimi e deri te monitorimi. Krejt kjo, sipas tij, do të bëhet me qëllim që realizimi i programit të jetë sa më efikas.

Ministri ka theksuar se krahas këtyre investimeve do ta zgjerojnë mbështetjen edhe për kultura të tjera bujqësore në sistemin e sigurimeve bujqësore, i cili është lansuar vitin e kaluar nga MBPZHR-ja në bashkëpunim me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC).

"Në politikat tona bujqësore prioritet do t'i japim edhe rritjes së investimeve në sistemet e ujitjes, pastaj subvencionimit të interesit të kredive të caktuara, si dhe certifikimit të produkteve me

potencial për eksport. Në gjithë këtë proces të investimeve do ta eliminojmë në çdo hap edhe burokracinë, me qëllim që sektori të avancohet dhe në të njëjtën kohë ta rrisim efikasitetin dhe arrijen e standardeve ndërkombëtare në të gjitha proceset bujqësore", ka thënë ministri Mustafa.

Gjatë këtij takimi shoqatat janë njoftuar edhe me masat e tjera mbështetëse në kuadër të programeve, të cilat janë mirëpritur nga ta dhe në të njëjtën kohë shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në çdo kohë me MBPZHR-në në çdo proces, që për qëllim ka përkrahjen e tyre në veprimtaritë bujqësore.

## KEDS-i mobilizoi mbi 250 punëtorë në zonat e prekura nga era e fortë

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Erërat e forta janë rikthyer në shumë pjesë të vendit. KEDS-i, për t'i menaxhuar sa më mirë këto situata, ka angazhuar mbi 250 punëtorë në terren të ndarë në


dhjetëra ekipe. Ata janë të pajisur me të gjitha makineritë e disponueshme dhe janë duke intervenuar në zonat e prekura nga këto kushte atmosferike. "KEDS-i u bënë apel qytetarëve që të

bashkëpunojnë me ekipet në terren dhe të mos i afrohen rrjetit elektrik nëse e shohin të dëmtuar, por ta raportojnë atë përmes Qendrës së Thirrjeve në numrin 0800 791 00 dhe rrjeteve sociale të kompanisë.

Gjatë stuhisë së fundit të erës me të cilën u ballafaqua Kosova, KEDS-i arriti që në kohë rekorde ta rikthejë energjinë deri te konsumatori i fundit", është thënë në njoftimin e KEDS-it.



# Kosova do t'i trajtojë me prioritet projektet dhe marrëveshjet me Bankën Botërore



**EPOKA ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Kryeministri i vendit, Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri Haki Abazi, ka pritur të mërkurën në takim drejtoreshën rajonale të Ballkanit Perëndimor, Linda Van Gelder, dhe drejtorin për Kosovë, Marco Mantovanelli, nga Banka Botërore.

Në këtë takim u paraqitën prioritetet e veprimit të shpejtë të qeverisë, me theks në projektligjin e buxhetit për vitin 2020, reduktimin dhe shkrirjen e numrit të ministrive dhe për përçimin e marrëveshjes së koalicionit në program qeverisës dhe plan pune. Kurti dhe Abazi shprehën

përkushtimin e qeverisë për objektivat e zhvillimit të vendit. "Këto objektiva synojnë t'i japin Kosovës atë për çka ka më tepër nevojë, substancë dhe përmbajtje. Brenga e shoqërisë sot është migrimi, ndaj dhe duhet menjëherë një plan zhvillimi që ua rikthen njerëzve besimin dhe guximin për të qëndruar këtu, si dhe që motivon njëherësh kthimin e trurit nga jashtë. Potencialet janë mes nesh, por investimet nuk janë adresuar në mënyrën e duhur dhe janë përqendruar në fushat e gabuara. Kryeministri shprehu edhe besimin se qeverisja do t'u kthejë njerëzve një lidhje të re me tokën e tyre, duke pasur parasysh këtu edhe pasuritë dhe burimet

natyrore. Kosova nuk duhet të jetë më një vend transit për qytetarët e vet. Kjo mendësi duhet të transformohet", është thënë në njoftimin e Qeverisë.

Nga përfaqësuesit e Bankës Botërore u shpreh vazhdimi i mbështetjes së Kosovës nëpërmjet Asociacionit për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA), gjë që ndodh përmes kredive e granteve me interes të ulët. Ata u shprehën edhe mbi dy prioritetet e Bankës Botërore për fokusim në sigurinë e ujërave, pastrimin dhe mbrojtjen e ambientit.

Edhe zëvendëskryeministri i parë në Qeverinë e Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur në takim drejtoreshën Rajonale të Bankës Botërore për Ballkanin

Perëndimor, Linda Van Gelder, dhe përfaqësuesin e Bankës Botërore për Kosovë, Marco Mantovanelli. Gjatë takimit, zëvendëskryeministri falënderoi përfaqësuesit e Bankës Botërore për mbështetjen dhënë Kosovës, duke kërkuar që edhe më tutje të vazhdojë ky bashkëpunim.

Drejtoreshën rajonale për Ballkanin Perëndimor, Linda Van Gelder, e ka pritur të mërkurën në takim edhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani. Ajo ka premtuar vazhdimin e mbështetjes së Kosovës nga ana e Bankës Botërore në disa sfera, ndër të cilat edhe për arsimin, shëndetësinë dhe mjedisin.

Kryeparlamentarja Osmani ka konfirmuar vazhdimin e

bashkëpunimit me Bankën Botërore, duke i trajtuar me prioritet të gjitha projektet dhe marrëveshjet e kësaj organizate me institucionet e Kosovës. Gjithashtu, edhe ministri i Infrastrukturs dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, ka pritur në takim drejtoreshën Rajonale të Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, Linda Van Gelder, bashkë me përfaqësuesit e zyrës së këtij institucioni në Kosovë.

Abdixhiku dhe Gelder diskutuan për projektet e përbashkëta që janë në implementim e sipër dhe ato që mund të gjejnë zbatim në të ardhmen. Me këtë rast, Abdixhiku shpallosi edhe prioritetet e qeverisjes për fushat që mbulon ministria që ai drejton.

## Kryeshefi i KOSTT-it nënshkruan memorandum me Swissgrid



**PRISHTINË, 26 SHKURT (ER)** - Në kuadër të angazhimeve në funksion të avancimit të partneriteteve, bashkëpunimit dhe integritimit në mekanizmat ndërkombëtarë, të mërkurën kryeshefi ekzekutiv i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT), Ilir M. Shala, ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Zvicrës (SwissGrid).

Swissgrid si anëtar aktiv i Rrjetit të Operatorëve Evropianë të

Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E) mban rolin e përgjegjës për Qendrën Koordinuese Jug dhe në kuadër të këtij roli përmes marrëveshjes së nënshkruar do të mund të sigurojë asistencë teknike si dhe trajnim për punonjësit e KOSTT në fushën e Rregullimit të Frekuencës-Ngarkesës (LFC) si dhe zbatimin dhe funksionimin e Bllokut Rregullues.

Kjo do të jetë një mundësi e shkëlqyer për operatorët tanë për zhvillim profesional dhe

përgatitje për obligimet e reja, të cilat do t'i marrë KOSTT-i së shpejti me fillimin e funksionimit të pavarur brenda Bllokut Rregullues Kosovë - Shqipëri dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së re të Kycjes me ENTSO-E.

Të dy kompanitë nënshkruese mirëpresin shkëmbimin e njohurive që do të jenë në dobi të ndërsjellë si dhe do të jenë në funksion të mbështetjes së stabilitetit të përgjithshëm të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike në gjithë Evropën.

## Ruqiqi ia prezanton Kurtit prioritetet e OEK-ut

**PRISHTINË, 26 SHKURT (ER)** - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti dhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Ruqi, kanë diskutuar të mërkurën rreth bashkëpunimit ndërinstitucional dhe për fuqizimin e dialogut publiko-

privat në funksion të fuqizimit të sektorit privat.

Ruqiqi ka prezantuar prioritetet e OEK-ut dhe kërkesat specifike të anëtarëve për temat: sundimi i ligjit, eksporti, investimet, oda dhe fuqizimi i rolit të odës, prodhimet vendore, informaliteti, edukimi dhe

punësimi, politikat fiskale, prokurimi publik, marrëdhëniet tregtare rajonale dhe digjitalizimi.

Kryeministri Kurti ka theksuar rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit me OEK-un për avancimin e agjendës zhvillimore të vendit.



## Gjilani po i bën përgatitjet e fundit për hapjen puseve të reja

GJILAN, 26 SHKURT (ER) - Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me kompaninë regjionale të ujërave "Hidromorava" është duke i bërë përgatitjet e fundit për hapjen e puseve të reja si formë emergjente e zgjidhjes së problemit të ujit të pijshëm. Lajmi është bërë me dije të mërkurën pas vizitës së nënkryetarit të Gjilanit, Arbër Ismajli dhe drejtorëve komunalë, Naser Korça e Nevzad Rushiti, në KRU "Hidromorava", ku janë pritur



nga drejtori Muhamet Suliqi. "Përpos puseve që janë funksionalizuar, bashkë me 'Hidromoravën' jemi duke i bërë hulumtimet e fundit të burimeve alternative për hapjen edhe të puseve të tjera", ka thënë Ismajli. Ismajli e Suliqi janë shprehur se pas miratimit të buxhetit të shtetit nga Kuvendi i Republikës kësaj komune pritet t'i ndahen afro 500 mijë euro, që llogaritet si zgjidhje emergjente, ndërkaq që

zgjdhja afatmesme është vlerësuar ndërtimi i pendës në lumin Llapushnica. Gjilani është furnizuar nga katër burime të ujit të pijshëm, ku në kohën e normalitetit janë prodhuar mbi 300 litra për sekondë, ndërsa tash prodhohen pak më shumë se 100 litra për sekondë. Ismajli e Suliqi kanë thënë se hapja e pesë puseve të reja brenda kazermës së FSK-së ka bërë që prodhimi të shtohet për 30 litra për sekondë.

## Mbyllet lokali 'Shisha Lounge - Imperial' në Skenderaj

SKENDERAJ, 26 SHKURT (ER) - Nga inspektimet rutinore dhe ato të bëra me kërkesë të qytetarëve, inspeksioni komunal i Skenderajt ka hasur në frekuentim të fëmijëve nën moshën 18-vjeçare në lokalit "Shisha Lounge-Imperial", me ç'rast ka gjobitur pronarin e lokalit në fjalë për mosrespektim të ligjit. "Pas marrjes së informatës që i njëjti biznes përsëri në mënyrë të jashtëligjshme ka shërbyer fëmijët nën moshën 18-vjeçare me shisha, sipas ligjit, lokali është mbyllur përkohësisht. Me këtë rast, Komuna e Skenderajt kërkon nga të gjitha bizneset që fëmijët nën moshën 18-vjeçare të mos shërbehen me produkte të ndaluara sipas ligjit duke përfshirë,



duhanin, alkoolin, shisha etj., përndryshe inspeksioni komunal do të marrë masa ndëshkimore sipas ligjit", është bërë me dije në njoftimin e Komunes së Skenderajt.

## Komuna e Dragashit kërkon nga shkollat që të pajisen me material higjienik

DRAGASH, 26 SHKURT (ER) - Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash ka kërkuar që në të gjitha shkollat e kësaj komune ora e parë e mësimi të ndërrimit të paradites dhe ora e parë e ndërrimit të pasdites nesër t'i kushtohet rritjes së vetëdijimit të nxënësve lidhur me masat parandaluese rreth koronavirusit, duke u bazuar në materialet dhe udhëzimet e pranuar nga Instituti Kombëtar për Shëndet Publik, të cilat janë shpërndarë nëpër shkollat. Po ashtu, udhëzon drejtorët e shkollave që t'i pajisin shkollat me



material higjienik dhe të gjitha institucionet shkollore ta bëjnë dezinfektimin e shtuar të të gjitha sipërfaqeve dhe nyjave sanitare.

## Kampioni Botëror në floktari, Besmir Hoxha viziton Malishevën

MALISHEVË, 26 SHKURT (ER) - Nënkyetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, e ka pritur të mërkurën në një takim kampionin botëror në fushën e parukerisë, përkatësisht për tatuazhet e flokëve, me rrojë, Besmir Hoxhën nga fshati Marali i Malishevës, i cili ishte i shoqëruar edhe nga kryetari i Federatës Botërore të Parukerisë, Giancarlo Milanese. Nënkyetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, e ka uruar Besmir Hoxhën për suksesin e arritur. "Në çdo fushë

që arrihen suksese për ne do të thotë shumë, pasi pjesëmarrja në ngjarje të tilla me karakter ndërkombëtar është përfaqësimi më i mirë që na bëhet jo vetëm si komunë, por si vend", ka thënë Berisha. Ndërsa kryetari i kësaj federate, Giancarlo Milanese, ka theksuar se ka një grup të madh të mjeshtërve të fushës së parukerisë, pasi nuk janë thjesht floktarë, por e njohin profesionin dhe po tregojnë rezultate të jashtëzakonshme në këto gara dhe po sjellin risi në

fushën e floktarisë. Nga ana tjetër, kampioni botëror Besmir Hoxha e ka falënderuar komunën për këtë pritje, që për të do të thotë shumë, pasi ndihet i përkrahur dhe i motivuar nga ana e komunës. Ai njoftoi se shumë shpejt do ta përfaqësojë Kosovën në një garë tjetër e cila do të mbahet në Romë. Besmir Hoxha e ka zënë vendin e parë në International Cup 2020, që është mbajtur në Shqipëri më 16 dhe 17 shkurt, në kategorinë Razor Hair Tattoo.



## Avni Fetahu i bashkohet Lëvizjes Vetëvendosje

PODUJEVË, 26 SHKURT (ER) - Lëvizjes Vetëvendosje i është bashkuar Avni Fetahu, asamblist në Kuvendin Komunal të Podujevës dhe kryesues i Këshilltarëve Komunalë të LDK-së në këtë komunë. Sipas një njoftimi të LV-së, Avniu është magjistër në drejtimin Menaxhment dhe Informatikë

në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. "Përvoja, dija e tij dhe profesionalizmi i Avni Fetahut do t'i shërbejë shumë lëvizjes sonë si në nivelin lokal, po ashtu edhe në atë qendror. Avni Fetahu ka përvojë të gjatë menaxheriale duke qenë drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit

Ekonomik si dhe drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën e Podujevës. Ka marrë pjesë në shumë vizita studimore dhe në konferenca ndërkombëtare. Avniu është mesimdhënës në Shkollën Ekonomike 'Isa Boletini'. Është i martuar dhe prind i pesë fëmijëve", është thënë në njoftimin e LV-së.

# PO KU JE O ADEM DEMAÇI QË TË KEMI HARRUAR SE KE JETUAR NDONJËHERË!



Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

**Me kohë po ndryshojmë edhe ne:** Thuhet se koha i ndryshon njerëzit, i shëron plagët e atyre që i kanë pasur, hap plagë të reja në shpirt dhe ndërgjegje, vendos maska në pafytyrat e shpërfytyruara, heq maska në pafytyrat e dëshmuara, ndryshon bindje politike, tradhtarët i bënë patriotë me intervenime politike, ndryshkun moral dhe kombëtar i mbylon me flakërimë të arit, i jep poste të rëndësishme një hajvan gomarit sikur që ia tredhë koçet filan politikanit a kryetarit! Po e sheh se edhe unë, si një mashtrues potencial, kam filluar të ndryshoj. Dikur të quaja Baca i Madh Adem Demaçi, kurse tani vetëm Adem Demaçi. Madje e kam vënë këtë në titullin e shkrimit për të dëshmuar se po ua luaj bishtin atyre që të kanë përndjekur dhe po u përshtatem pushteteve të kaluara, e sidomos këtij që ka ardhur. Edhe vetë më thoshe se frika është njerëzore, se distancimi nga e kaluara e gabuar është hyjnore nëse bëhen për komb, fe dhe atdhe! Sot e kishin bërë një ekspozitë me fotot që i kishin bërë në periudha të ndryshme të jetës njëmijëvjeçare që e bëre sikur edhe portrete të pikturuara nga artistë të shquar dhe patriotë të dëshmuar, politikisht të dështuar.

Sot takova disa shokë që ende të kanë mbetur besnikë, gjysmëbesnikë dhe jobesnikë, shokë të idealit dhe shokë të interesit që ende të përdorin si faturë për t'i mbuluar babëzitet dhe hyrjen thellë në lakra. Ishte doktori Hakiu që ende është i palëkundur dhe nuk i është nënshtruar apo dorëzuar asnjë tundimi, Dul Teraku, Nuh Llapqini dhe Baraleci. Mungonte Elmiu sikur edhe Binak Dinaj - Naku për t'u kompletuar grupi që rrinim bashkë, që vazhduam të jemi bashkë, ndonëse nuk je me ne por se gjithmonë ishe dhe

mbete ylli ndriçues dhe orientues në rrugëtimin jetësor ndonëse, siç thonë në Rahovec, kemi hyrë në rrugën vellika teposhtëza. Ishte edhe Bekimi i Qalit, shoferit, përcjellësit dhe këshilltarit e kohëve më të vështira, kohëve të luftës kur fasulja hahej kokërr-kokërr dhe kur edhe ëndërra e kishte tjetër kuptim.

Baca Adem, thoshe se Kosova dhe shqiptarët asnjëherë nuk kanë qenë më mirë. Se qenia jonë kombëtare ka shpëtuar dhe se më nuk rrezikohet as nga Serbia, as nga Kina e as nga Rusia. Në fakt, na ka hyrë frika në palcë nga Kina, nga koronavirusi. Për Serbinë mos ke merak, është këtu, e fortë, por jo në krye të oxhakut. E sollën dhe e forcuan shokët tanë, kurse "krahu paqësor" asnjëherë nuk e pati larguar, as nga zemra e as nga mendja.

Në Kosovë kemi ndërrim të pushtetit dhe qeverisë. Shkoi krahu i luftës, erdhi shqiponja dykrenore, LV dhe LDK. Prandaj rri i qetë atje ku je se ka kush ta mbrojë Kosovën. Kosova është shndërruar në vend të dhunshëm, madje shumë të dhunshëm. Merre me mend se çfarë dhune është ushtruar ndaj zëvendës kryeministrit të parë Avdullah Hotit; ia kanë rrezikuar jetën duke e gjuajtur me vezë të "Konsonit". Me të drejtë kanë reaguar të gjithë; nga subjektet politike në pushtet, ambasadorët e vendeve të fuqishme dhe pritet të deklarohet edhe NATO, BE dhe Departamenti i Shtetit. Na turpëruan, o Bacë! Me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës, të lavdëruan edhe ata që të kanë pushkatuar shumë e shumë herë, të kanë vrarë për së gjalli, të kanë shpallur të matufosur, si baba të Ballkanisë dhe vëlla të serbëve, nuk të kanë lënë kurrë të të ngrohë dielli politik duke të marginalizuar dhe duke favorizuar ata që, jo se nuk kontribuan asnjë minutë të vetme për Kosovën, por se tërë jetën ia kushtuan luftës kundër Kosovës duke i shërbyer qençe Jugosllavisë dhe Serbisë. Sot, o Bacë, fëmijët dhe pasardhësit biologjikë të bastardëve kombëtarë dhe njerëzorë janë të punësuar si këshilltarë, ambasadorë, konsuj dhe janë bartës të posteve të larta

institucionale. Fëmijët tanë, ndonëse kanë mbaruar shkollimin e duhur, punojnë kamerierë, punëtorë fizikë apo kërkojnë rrugë dhe mundësi t'i thonë Kosovës lamtumirë. Fëmijët e politikanëve, ndonëse një numër i tyre i kriminalizuar dhe me koeficient të jointelegjencës si të një të sëmuri me të meta mendore, mbajnë disa vende të punës, mbyten në luks dhe e shëtisin botën, me para të vjedhura nga shtresat e varfëruara, fëmijët tanë e kanë problem ta vizitojnë shpellën e Gadimes.

Kosova sot është në një ankand publik ku nuk e ka të sigurt territorin e as pavarësinë. Sot jeni me Mitrovicën, nesër mund të jeni pa të! Ndrikullat ndërkombëtare po e abortojnë Kosovën, së bashku me mamitë politike të Kosovës të mbushura me injorancë të skajshme dhe të shantazuara me çka të duan! Ata që më së shumti pësuan dhe u flijuan për Kosovën jo vetëm këto vite të fundit, por që nga koha e Rilindjes kombëtare, nuk janë askund! Edhe ty Bacë po mundohen të të vënë në askund! Sot kemi të ashtuquajturin president historik, arkitekt i pavarësisë së Kosovës, ndonëse në jetën e vet nuk e ka vënë një pikë për pavarësi e lëre më të ketë bërë projekte të tilla. Edhe te varret kanë bërë dallime. Ishim te varri i gjeneral Shaban Shalës i cili tërë jetën ia kushtoi luftës për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar. Ndonëse u bënë 8 vjet nga koha kur iku në amshim, varri i gjeneralit të UÇK-së, patriotit këmbëngulës më shumë i ngjante një varri të një të vdekuri pa familje dhe të cilin, me shpenzime komunale, është varrosur nga shërbimet komunale. Turp, o Baca Adem, turp i madh!

**Çka po ndodhë në Kosovë:** Po flitet për vazhdimin e bisedimeve me Serbinë në kohën kur, gjithashtu, po flitet për një marrëveshje përfundimtare që duhet të arrihet deri në fund të vitit. Albin Kurti është kryeministër i Kosovës dhe duket se nuk do të ketë kohë fare të merret me bisedime me Serbinë, por se do të merret vetëm me pasojat, pa fajin e tij. I kanë mbetur këmbët e arushës (Hashimit) në duar.

Mbesa e shokut tënd të idealit, të jetës, vuajtjeve dhe sakrificës, Ahmet Haxhiut është bërë ministre, sa për informatë. Gjykata Speciale po u rri mbi kokë shokëve tuaj, një pjesë e të cilëve fort po trembet. Bacë, nuk mund ta besosh gëzimin që po e ndiejnë mbeturinat e Jugosllavisë dhe Serbisë dhe nervozën pse këta ende nuk janë arrestuar, pse nuk po dënohen dhe pse nuk po vihen në trekëmbësh. Nuk ka as ndjeshmëri elementare për 12 000 shqiptarë të vrarë, mbi 1 300 të zhdukur pa nam dhe nishan, me mijëra femra të dhunuara e dëme të mëdha materiale sepse, në vend se të kërkohet përgjegjësi për ta, po kërkohet përgjegjësi për shqiptarët, ata që e bënë luftën dhe ata që e përkrahën. Nuk mbeti kush pa u ftuar nga kjo Gjykatë, sikur të ishte një Gjykatë për Kundërvajtje dhe po merret me shkelësit e qetësisë publike pas një demonstrate. Shqiptarët janë ndarë fort, Hashimi në një anë, kurse Albini dhe Vjosa në anën tjetër. Nuk po e kanë një pikë takimi as për çështje të mëdha të kombit dhe të shtetit. Isa Mustafa po i tërheq penjtë nga hija me një saktësi të çmendur dhe filigranike.

Bacë, kohët e fundit i vetmi që ka pyetur se ku është Adem Demaçi është Nasim Haradinaj të cilin e kanë gozhduar sepse e ka thënë një të vërtetë publikisht kur të tjerët, për shkaqe të ndryshme, nuk kanë guxim ta thonë. Është bërë si në kohën e ish-Jugosllavisë kur sanksionohej fjala e lirë. Sot në Kosovë ta thuash të vërtetën është e dënueshme dhe nuk mund të kaloni pa pasoja. Baca Adem, si asnjëherë më parë, sot kemi nevojë të bashkohemi, sidomos ata që e pësuan në të kaluarën. Bacë, sot kur kalojmë para torturuesve tanë në hetime, policë apo hetues e që janë sistemuar edhe më mirë në Kosovën demokratike, para prokurorëve dhe gjykatësve që na dënuan, duhet ta ulim kokën dhe thuaja turpërohemi për krimet që i kanë bërë ndaj nesh që e deshëm lirinë. Pra, dashja e lirisë edhe sot llogaritet krim.

Sot, o Baca Adem, më shumë respektohet nga shokët tanë Gjat Macolli që kurrë dhe asgjë nuk ka bërë për lirinë e Kosovës

se ti që 30 vjet kalove nëpër të gjithë rrathët e ferrit. Shokët tanë që janë bastarduar atij i thonë bacë për faktin se ua ka mbushur cullën me mish dhe xhepat me para. Sot edhe kullat e Adem Jasharit janë duke u shembur për të ndërtuar varre dhe memoriale për ata që nuk e shkrepën, jo një plumb, por edhe as një pordhë të vetme për lirinë e Kosovës. Bacë, atje ku je, mirë je dhe shoqërinë e ke shumë më të mirë, më të ndershme, më kombëtare dhe më besnike; je me Fehmiun dhe Xhevën, me Rexhep Malën dhe Nuhi Berishën, me Ahmet Haxhiun dhe Remzi Ademajn, me Adem, Hamëz dhe Shaban Jasharin, me Ilaz Kodrën dhe Abedin Rexhën, Ilir Konushevcin, Bahri dhe Fahri Fazliun, me Shaban Polluzhën dhe Mehmet Gradicën, me Azem Bejtën dhe Shotë Galicën, Tahir dhe Nebih Mehajn sikur edhe me mësuesin politik dhe ushtarak që e kishe, Hasan Prishtinën.

Baca Adem, me rastin e përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës edhe ty të përmenden, dikush sa për sy e pa faqe, dikush me zemër e dikush me thembër. Besa, duke shkuar te varri i Him Govës, morën në thua edhe te varri yt dhe luftëtarëve që të shoqërojnë. U ndalën edhe te Ti, Albini dhe Vjosa. I kam lexuar të gjitha ato që janë shkruar dhe folur për ty dhe më së shumti më ka bërë çudi deklarata e Hakiut të Abazoviqe, të cilin Albini e bëri zëvendës të vetin. Ky Hakiu e ka bërë një postim shumë përmbytësor, real dhe një pasqyrim të jetës dhe veprës sate. Bacë, nganjëherë është më mirë të të mos ta vizitojnë fare varrin tënd se të vjen turli halahuli para historisë dhe kutimit të lirisë që ishte Ti Bacë e që po mundohen ta prangosin në një hapësirë dy me një metër. Bacë, për ty po shkruajnë edhe ata që nuk i ke dashur, edhe ata që nuk të kanë dashur asnjëherë dhe duket se ka ardhur koha të bëhet ndryshe. Nëse jemi gjallë dhe shëndosh, e vazhdojmë edhe në të ardhmen siç e bënim sa ishim bashkë me një grusht shokësh që ende e ndiejnë mungesën tënde! Që ende të thërrasin dhe të konsiderojnë si Bacë, si udhëheqës shpirtëror dhe si një enciklopedi të pashkruar deri më tani.

## Papa nuk do ta vizitojë Irakun këtë vit

VATIKAN, 26 SHKURT - Papa Françesku tha se ai nuk do ta vizitojë Irakun këtë vit.

Papa e bëri njoftimin para një grupi të irakianëve, gjatë një audience të përgjithshme në sheshin "Shën Pjetri" në Vatikan, duke thënë se udhëtimi potencialisht i rrezikshëm ishte shtyrë në kohë të pacaktuar.

"Për ju qytetarë të Irakut, unë them që jam shumë afër jush.

Ju jeni në një fushë beteje. Ju vuani nga lufta", tha ai.

Papa kishte thënë se dëshiron të vizitonte Irakun, por për shkak të shqetësimeve të sigurisë, udhëtimi nuk u njoftua kurrë nga Vatikan dhe përgatitjet nuk arritën një fazë zyrtare.

Popullsia e vogël e krishterë në Irak pësoi vështirësi të veçanta kur grupi militant ekstremist Shteti Islamik kontrollonte

pjesë të mëdha të vendit.

Të krishterët në Irak, i kanë rikthyer liritë, që kur militantët e Shtetit Islamik u mundën nga forcat e koalicionit.

Muajin e kaluar, Papa Françesku u takua me presidentin e Irakut, Barham Salih, dhe të dy ranë dakord se sovraniteti kombëtar i vendit duhet të respektohet, pas sulmeve në territorin e tij nga Shtetet e Bashkuara dhe Irani.



## Bernie Sanders në shënjestër të kandidatëve demokratë

WASHINGTON, 26 SHKURT - Senatori amerikan Bernie Sanders ishte në shënjestër të rivalëve të tij për emërimin presidencial demokrat në debatin e fundit televiziv të mbajtur të martën në Charleston të Karolinës së Jugut. Sanders është kryesuesi i garës në nivel kombëtar pas fitoreve në tri zgjedhjet e para paraprake, por rivalët e tij thonë se socialisti i vetëshpallur demokrat do të humbiste ndaj presidentit republikan Donald Trump në zgjedhjet kombëtare të nëntorit, ka njoftuar voa.

Në konfrontimin ballë për ballë në debatin e organizuar nga CBS News, Sanders, një i pavarur nga Vermonti i cili u radhit me demokratët në Senat, u pyet se si do t'i bindte votuesit se do të ishte një drejtues më i mirë i ekonomisë sesa presidenti Trump, me gjithë rritjen e tregut të aksioneve.

"Vitin e kaluar, rritja reale e pagave për një punëtor mesatar ishte më pak se 1%. Gjysma e njerëzve jetojnë duke pritur nga një rrogë të tjetra. Kjo nuk është një ekonomi që punon për popullin amerikan por një ekonomi, që punon për 1% të popullit. Ne do të krijojmë një ekonomi për të gjithë, jo vetëm për kontribuuesit e pasur të fushatës", tha senatori Bernie Sanders.

Sanders ka premtuar të zgjerojë Medicare, programin e sigurimeve shëndetësore për të moshuarit amerikanë, për ta vënë atë në dispozicion për të



*Bernie Sanders është kryesuesi i garës në nivel kombëtar pas fitoreve në tri zgjedhjet e para paraprake, por rivalët e tij thonë se socialisti i vetëshpallur demokrat do të humbiste ndaj presidentit republikan Donald Trump në zgjedhjet kombëtare të nëntorit*

gjithë, pavarësisht nga mosha. Por rivalët e tij, përfshirë senatorin e Minesotës, Amy Klobuchar, pretendojnë se planet e Sandersit për t'i rritur ndjeshëm shpenzimet e mirëqenies sociale për shëndetin dhe arsimin do të ishin shumë të kushtueshme.

"Jo, matematika flet ndryshe. Në një emision televiziv këtë javë ai tha se nuk do t'i shpjegonte në hollësi shpenzimet për planin.

Epo, më lejoni t'ju them se për sa shpenzime bëhet fjalë - afro 60 trilionë dollarë. A e dini se sa është kjo shumë për të gjitha programet e tij?", tha ai.

"Kjo është sa tri herë ekonomia amerikane, jo qeveria federale, e gjithë ekonomia amerikane", tha senatorja Klobuchar.

Ish-nënpresidenti Joe Biden përdori rastin e një sulmi me armë në një kishë kryesisht afrikano-amerikane në Charleston

në vitin 2015 për të sulmuar Sandersin për kundërshtimin e tij të mëparshëm me legjislacionin që do t'i mbante prodhuesit e armëve përgjegjës për dhunën me armë në Shtetet e Bashkuara.

"Bernie votoi pesë herë kundër projekt-ligjit Brady, dhe kërkoi një periudhë pritjeje vetëm prej 12 orësh. Unë nuk po them se ai është përgjegjës për nëntë vdekjet në atë incident, por

vrasësi nuk do të kishte qenë në gjendje të merrte atë armë me një periudhë pritjeje sa ajo që kisha sugjeruar unë", tha Biden. Kundërshtarët e Sanders kanë thënë gjithashtu se vlerësimet e tij të favorshme për dekada të tëra për diktatorë të tillë të majtë, si Fidel Castro i Kubës do të refuzoheshin nga votuesit e moderuar dhe konservatorë në pjesë të caktuara të vendit. Ish-kryetari i bashkisë së Nju Jorkut, Michael Bloomberg madje sugjeroi që Sandersi po përdorej nga presidenti rus Vladimir Putin.

"Donald Trumpi mendon se do të ishte më mirë që ai të jetë president. Unë nuk mendoj kështu. Vladimir Putini mendon se Donald Trumpi është - duhet të jetë presidenti i Shteteve të Bashkuara, dhe kjo është arsyeja pse Rusia po ju ndihmon të zgjidhen kandidat në mënyrë që të humbisni", tha Bloombergu.

Debati vjen vetëm katër ditë para se Karolina e Jugut, me 54 delegatët e saj kombëtar në lojë, t'i mbajë zgjedhjet paraprake. Biden, i cili dikur ishte kryesues i garës, mban një epërsi të ngushtë ndaj Sandersit në Karolinën e Jugut, por vëzhguesit thonë se ekziston mundësia që Sandersi gjithashtu mund të fitojë shtetin, duke e vendosur atë në një pozicion komandues përpara të ashtuquajturës "Super e marta" votimi tri ditë më vonë, kur vendoset se kush do të marrë më shumë se 1300 delegatë.

## Janez Jansha, kandidat për kryeministër të Sllovenisë

LUBJANË, 26 SHKURT - Presidenti slloven, Borut Pahor, të mërkurën, emëroi ish-kryeministrin, Janez Jansha, kandidat për kryeministër të ri dhe i kërkoi parlamentit të konfirmojë emërimin e tij.

Javën e ardhshme, pritet që parlamenti të konfirmojë, kreun e Partisë Demokratike Sllovene (SDS), Janez Jansha, në pozitën e kryeministrit.

Ai do të zëvendësonte Marjan Sarec, nga partia e qendrës së majtë, i cili dha dorëheqjen

muajin e kaluar.

"Në bisedime me grupet parlamentare zbulova se kandidati gëzon mbështetje të shumicës, dhe se ne mund të presim konfirmimin e tij në parlament", tha presidenti, Borut Pahor

Emërimi vjen një ditë pasi SDS-ja ra dakord për një koalicion me partinë e qendrës së djathtë Qendra Moderne, partinë konservatore Sllovenia e Re dhe partinë e pensionistëve Desus.

Të katër partitë së bashku mbajnë 48 nga 90 vendet në parlament.

Jansha, 61 vjeç, drejtoi Qeverinë sllovene nga viti 2004 deri më 2008 dhe nga 2012-ta deri më 2013.

Ai është i afërt me kryeministrin hungarez, Viktor Orban, dhe ka mbrojtur politikën e kontrolleve të rrepta kufitare për të parandaluar fluksin e migrantëve të paligjshëm.

Sipas marrëveshjes së koalicionit, qeveria e tij do t'i rrisë



pensionet dhe do t'iu japë më shumë para nga buxheti qeverive lokale.

Pasi të konfirmohet nga parla-

menti, Jansha do të ketë 15 ditë për të paraqitur qeverinë e tij, e cila pritet të miratohet nga parlamenti deri në fund të marsit.



## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**

# Kosova po bëhet me film të gjatë të animuar, "Zhak" në fazën e fundit të xhirimeve

I nisur në shkurt të vitit 2016, filmi i parë shqiptar i animuar i metrazhit të gjatë "Zhak", pas katër viteve punë intensive ka arritur deri te xhirimet përfundimtare

Duke pas parasysh që një film i animuar i metrazhit të gjatë po xhirohet për herë të parë në Kosovë edhe vështirësitë nuk janë të pakta, vitet 2016-2017 kanë qenë më shumë testim të teknologjisë.

I bazuar në përrallat shqiptare popullore, filmi tash ka ardhur në pikën përfundimtare dhe ka nisë xhirimet të cilat pritet të zgjasin rreth 6 muaj.

Themeluesit e neoFILMS, njëherit skenaristë dhe regjisorë të filmit "Zhak", Ilirjana Bejta dhe Dalip Gashi pas një pune plotë përkushtim, janë të bindur që filmi do të realizohet në mënyrën

duhet të realizohet jashtë shtetit. Sa i përket muzikës dhe sound effects ajo pohon se tashmë janë në diskutime me disa kompani të ndryshme në LA.

Ky projekt është i gjerë dhe ka rreth 120 personazhe, 80 prej tyre kërkojnë aktor dhe aktore specifike të dedikuara për rolet në fjalë, por në përgjithësi kërkon rreth 250 pjesëmarrës, ushtarë dhe statistë të ndryshëm.

"Pjesëmarrja e aktorëve është e rregulluar në atë mënyrë që përgjatë procesit të animacionit angazhohen sipas nevojës. Momentalisht i angazhuar në rolin e Zhakut është Dukagjin



angazhohet edhe aktor të njohur Hollywoodian anëtarë të Motion Pictures Association, disa prej tyre tashmë edhe i kanë kontaktuar.

Ashtu si në secilën fushë kur diçka realizohet për herë të parë në një vend, respektivisht në Kosovë, ku përkrahja për këtë tip filmi mungon. Duke pas parasysh këtë fakt, filmi i animuar në Kosovë ka vështirësi të dyfishta.

"Problemi elementar është mungesa e informacionit praktik, mungesa e përvojës, prandaj gjithçka deri më tash na ka marr kohë dy herë më shumë se që duhet, sepse secilin problem praktik, kryesisht teknologjik, është dashur ta zgjidhim me forcat tona", ka treguar Ilirjana rreth vështirësive.

Pjesa teknike është elementi i parë që duhet krijuar kushtet e përshtatshme për të nisur xhirimet, por neoFILMS kanë arritur të kompletojnë një ekip mjaft të mirë.

"Duke pas parasysh që jemi kompania e vetme në Kosovë e këtij lloji (full SGI VFX) ka qenë e vështirë të krijohet ekipa adekuate, por sot kemi një ekipë prej rreth 25 vetash shumë profesionist dhe pothuajse secili nga ta është generalist, veçanti e rrallë në këtë fushë. Kemi organizuar

trajtime të ndryshme, kryesisht online dhe sot dy nga ekipa jonë janë të licencuar nga Autodesk Maya; Valon Iseni dhe Diar Pepiqi, gjithashtu brenda vitit presim që së paku edhe pesë të tjerë të licencohen. Licencimi nga kjo kompani gjigande dëshmon që realisht edhe ne mund të jemi konkurrent për botën sa i përket realizimit dhe kualitetit në fushën e 3D dhe animacionit. Është shumë e rëndësishme të përmendet gatishmëria e të rinjve tanë dhe potenciali i jashtëzakonshëm që po tregojnë në këtë fushë."

Filmi është në gjuhën angleze


ishte së paku rreth 90 milion euro. Deri këtu i gjithë investimi ka qenë me baza vullnetare dhe të gjithë investitorët janë të publikuar në IMDb. Aktualisht jemi në diskutime me investitor vendor dhe të jashtëm në mënyrë që investimin prej 4 milionësh ta bëjmë së paku 10 milion."

Për kohës se kur pritet premiera, regjisorja Bejta ende nuk mund të japë një kohë të caktuar, por megjithatë dihet që premiera do të jepet në Los Angeles.

"Duke pas parasysh natyrën e filmit dhe kërkesën e jashtëzakonshme teknologjike dhe për shkak të problemeve eventuale teknike, është herët të përcaktohet premiera. Ndërsa premiera do të bëhet në Los Angeles dhe me disa nga distributorët që kemi kontakt kanë shprehur interes që të mos kufizohemi me vetëm një premierë. Përveç në US, projekti do të dal njëkohësisht nëpër të gjitha kinematë botërore."

Filmi "Zhak" është duke u punuar me kujdes të veçantë dhe pretendimet nuk janë vetëm komerciale, por edhe artistike.

"Vet fakti që do shpërndahet në US dhe do të ketë të angazhuar dy ose më shumë anëtarë të Motion Pictures Association e bënë



më të mirë të mundshme.

Xhirimet e filmit kanë filluar para dy dite, por sipas regjisorës Bejta, puna po ecën mirë dhe duke i pas parasysh rrethanat dhe problemet e mundshme teknike ajo beson se këto xhirime do zgjasin rreth 6 muaj.

"Ky tip filmi kërkon angazhim pothuajse tre herë më shumë se sa një film jo animacion dhe kërkon më shumë se tre herë teknologji dhe përsëritje të proceseve të njëjta, ku dallon vetëm fokusi, si rezultat ka qenë jashtëzakonisht e vështirë, por, sipas nesh, është i vetmi version përmes së cilit mund të konkurrojmë me kualitetin që aktualisht është prezent në botë, në veçanti në US", ka thënë regjisorja, duke treguar tutje se problem tjetër është kualiteti i fotografisë 4K dhe mbështetja e teknologjisë Real D 3D dhe IMAX, që gjithashtu kërkohet Sound Effects me kualitet 5.1 Dolby Digital, proces i cili nuk mund të realizohet në asnjë vend të rajonit, prandaj paraqet problem dhe gjithësi

Podrimaj, në rolin e 'Babait të Verbër' është i angazhuar Shaqir Bejta dhe në rolin e 'Motrës së Zhakut' është e angazhuar Vjosë Tasholli.

Duhet ta kemi parasysh që të njëjtin rol mund dhe do ta ndajnë disa aktor, roli ndahet në tri pjesë; lëvizjet e trupit, lëvizjet e fytyrës dhe zëri (Voice Over)."

Për 'Voice Over' (zërin) produksioni po bën përpjekje që të



dhe është duke u punuar për tregun amerikan, por filmi pritet të jetë shumë i suksesshëm edhe në Kosovë.

"Filmi "Zhak" do të shpërndahet në gjithë botën dhe kemi besim se po të njëjtin sukses do ta ketë edhe në Kosovë, duke pasur parasysh që gjithçka është produkt 100% i Kosovës."

Filmi ka një buxhet të madh prej afër 4 milionë euro, por kjo shumë sipas regjisorës nuk është e mjaftueshme.

"Në fakt buxheti prej 4 milion eurosh është buxhet tepër i ulët për natyrën e filmit "Zhak", nëse ky film me të njëjtin kualitet do të prodhohej në USA, buxheti i nevojshëm për të do të duhej të

kandidat potencial për pjesëmarrje në "Oscars". Gjithashtu natyra e filmit "Zhak" është natyrë që përfshinë shikueshmëri nga grupmosha të ndryshme dhe nga shpërndarja botërore padyshim që presim edhe përfitime".

Krejt për fund ajo nuk harroi të falënderoj ekipin e filmit pa të cilët realizimi do të ishte i pamundur: Valon Iseni, Jeton Dajakaj, Valmir Gashi, Diar Pepiqi, Dardan Ejupi, Yll Sulejmani, Bekir Avdiu, Denis Deliu, Viktor Gashi, Dardan Rexha, Elvi Krasniqi, Vissar Rexha, Gramoz Hoxha, Endrit Gjini, Flamur Gashi, Korab Cena, Endrit Vitija, Sadik Sejdiu. /Jeta Zymberi/KultPlus.com/

# Zbulohen fjalët e fundit që John F. Kennedy tha 1 sekondë para së të vritej



Historia e dashurisë midis John F. Kennedy dhe gruas së tij, Jackie, ishte larg nga e përsosura, por ajo mori fund tragjikisht në vitin 1963 nga plumbi i një snajperi. Megjithatë, ajo mbetet si një nga romancat e mëdha të Amerikës, të dokumentuara në foto të ëmbla dhe nostalgjike. Dhe një arsye për këtë mund të jetë mënyra se si kaluan momentet e fundit dhe epilogu i tyre.

Më 22 nëntor 1963, Presidenti John F. Kennedy ishte ulur përkrah gruas së tij të veshur me shije me një kostum rozë të Chanel dhe kapelë me shirita dhe me një tufë me trëndafila të kuq që i ishin dhuruar nga fansat. Ata ishin ulur në sediljen

e pasme të një makine sedan Lincoln Continental të vitit 1961 së bashku me John Connally, Guvernatorin e Teksasit dhe gruan e tij, Nellie. Jackie po përshëndeste turmën që ishte mbledhur për të parë makinën presidenciale nëpër rrugët e Dallas.

Dhe pastaj erdhi momenti i konfuzionit të plotë. Ndërsa eskorta kaloi Magazinën e Librit Shkollor të Teksasit në Rrugën Elm, një zhurmë e fortë – si një fishekzjarr – u dëgjua në ajër. Presidenti Kennedy u pa duke rënë përpara. Jackie vuri krahët rreth tij. Pastaj një tjetër zhurmë e fortë dhe Jackie papritur u zvarrit në bagazhin e Lincoln. Ajo dukej se po merrte diçka.

*“Pamja në fytyrën e burrit të saj pasi ai u qëllua do ta ndiqte Jackie për pjesën tjetër të jetës së saj”, – thotë Christopher Anderson në librin “Viti Final i Jack me Jackie”. Fjalët e fundit që tha ajo për të ishin: “Unë të dua, Jack. Unë të dua”. Jackie e kujtoi atë situatë pak më ndryshe në një intervistë të vitit 1963, siç raportohet nga Neë York Daily News. Gjatë gjithë rrugës për në Spitalin Parkland, ku Presidenti Kennedy përfundimisht do të deklarohet i vdekur ajo u përkul duke e pyetur: “Jack, Jack, a mund të më dëgjosh? Unë të dua.”*

Ndërsa fjalët e fundit të Jack Kennedy për gruan e tij prej 10 vjetësh ishin natyrisht të tjera.

Ai nuk kishte asnjë mënyrë të dinte se çfarë do të ndodhte. Për shumë kohë është raportuar se fjalët e fundit të Jack ishin, *“Zoti im, unë jam goditur”,* por mjekët kanë thënë që kjo ishte e pamundur për shkak të dëmtimeve të Jack. Epo, historianët tani kanë sqaruar se fjalët e fundit që Jack foli para goditjes fatale ishin: *“Jo, sigurisht që nuk mundesh.”*

*“Jo, sigurisht që nuk mundesh?”* Ai po bisedonte në makinë me ata që e shoqëronin. *“Ju me siguri nuk mund të thoni që njerëzit e Dallas nuk ju kanë dhënë një mirëseardhje të këndshme,”* – i kishte thënë bashkëshortja e Guvernatorit të Teksasit sapo kishte vënë re tur-

mën e madhe që e adhuronte. *“Jo, ju me siguri nuk mundeni,”* u përgjigj Jack, milisekonda para se të goditej nga plumbi i armës së Lee Harvey Oswald. Presidenti ishte akoma gjallë kur u dërgua në spital më pak se 10 minuta më vonë.

Në spital, kur Ladybird Johnson e pyeti Jackie nëse ajo dëshironte të ndryshonte nga kostumin e gjakosur, Jackie nuk pranoi, duke thënë: *“Unë dua që ata të shohin se çfarë i kanë bërë Xhekut”.*

John F. Kennedy kurrë nuk foli një fjalë tjetër pas asaj dite fatale, por shumë gjëra që ai tha gjatë jetës së tij mbeten ende dhe janë dhe tepër frymëzuese.

/Përktheu LAPSI.al/

# Të humbur në përkthim!

Regjisorët gjithmonë rrezikojnë kur bëjnë filma në një gjuhë tjetër, shkruan Caspar Salmon.



Catherine Deneuve and Juliette Binoche in *The Truth*, directed by Hirokazu Kore-eda. Photograph: Laurent Champoussin/3B

Është fakt i pranuar në mënyrë universale në botën e kinemasë, se kur një autor i njohur e bën filmin e tij të parë jashtë gjuhës amtare, ai është duke e përgatitur një gjë pa shumë vlera. Ndaj, ishin alarmuese lajmet se **Hirokazu Kore-eda** po punon në një film në frëngjisht, pas suksesit me Palmën e Artë me filmin *"Manbiki Kazoku"* (*Familja e hajnave të dyqaneve*). A do të detyrohet bota të durojë një tjetër film si *"My Blueberry Night"* (*Netët e mia të boronicës*) – një limonadë e shërbyer nga **Wong Kar-wai** në debutimin e tij të parë në gjuhën angleze më 2007, pas dy dekadave të punës shumë të vlerësuar në Japoni?

Filmi i Kore-eda-s, *"La Vérité"* (*E vërteta*), nuk është dështim, por ka një mjegull të dendur rreth tij, një lloj monotonie, diçka që nuk ia del mbanë – mbase për faktin se mjeshtri po xhironte jashtë Japonisë. Pjesa tjetër e temës është aty: familja, kujtesa dhe mashtrimet e saj, fëmijëria dhe aktet e rastësishme të mizorisë që ia shkaktojmë njëri-tjetrit.

Por, kjo histori që vë përballë njëra-tjetrës aktoret **Catherine Deneuve** dhe **Juliette Binoche** – si nënë e bijë të armiqësuar – është më pak e fuqishme se puna e tij e zakonshme. Këtij ndërlikimi i shtohet fakti se burri i Binoche-s luhet nga **Ethan Hawke**, frëngjishtja e të cilit në rastin më të mirë është e çalë, kështu që aktori rri në heshtje, duke buzëqeshur tekta njerëzit përreth tij rrëfihen në frëngjisht, e herë pas here luan pak në kitarë. Diçka po shkon keq.

Problemet në situatat e tilla janë të shumëfishta, por dy janë kryesorët: si ta krijosh një dialog autentik dhe si t'i drejtosh aktorët tekta nuk e flet gjuhën e tyre. Në një version frëngjisht të filmit të shquar *"Jodaí-e Nadér az Simín"* (*Ndarja*), regjisori **Asghar Farhadi** foli në farsi, me një përkthyes që i transmetoi fjalët e tij në frëngjisht. Rreziku ashiqare shihet, por filmi *"Le Passé"* (*E kaluara*) është relativisht autentik për kohën dhe për vendin, megjithëse është e dukshme rënia e cilësisë nga *"Ndarja"*.

Shembujt tjerë janë të shumtë.

Ky muaj shënohet me daljen në kinema të filmit *"Little Joe"* (*Xhoi i vogël*), nga regjisorja austriake **Joeica Hausner** – filmi i saj i parë në gjuhën angleze pas një serie lëvdatash për filmat tjerë, përfshirë ata në frëngjisht, *"Lourdes"* (*Lurdi*) dhe *"Amour Fou"* (*Dashuria e çmendur*). Ishin ca dilema kur vitin e kaluar filmi u shfaq në Kanë dhe, përkundër guximit të saj, është vështirë të zërthehet sesa ishte e qëllimshme e pazakonshmeja. Filmat e Hausner-it gjithmonë ishin të prirë drejt të qëllimshmes, por kjo është ajo paqartësia për të cilën filmi nuk ka pasë nevojë.

**Yorgos Lanthimos** paraqet një histori të rrallë sukcesi, në kohët e fundit. Pas vlerësimeve për filmat e tij *"Kynodontas"* (*Dhëmbi*) dhe *"Alpeis"* (*Aplet*), regjisori grek merr vlerësime më të mëdha për filmat *"The Lobster"* (*Karavidhja*) dhe *"The Favorite"* (*Favoritja*) për të cilën **Olivia Colman** vitin e kaluar e fitoi çmimin Oscar. *"Karavidhja"* funksionon mbase edhe më mirë për efektin e çuditshëm distancues të

gjuhës në të. Personazhet e Lanthimos-it, të gjithë flasin me një stakato të çuditshme, dhe aty ka një boshllëk, një ndjenjë zhvendosjeje prapa dialogut i cili shpesh bën që personazhet të flasin pa nevojë. Kjo funksionon mjaft mirë në anglisht; mbi të gjitha, qëllimi i regjisorit nuk ishte të riprodhojë modelin autentik të fjalimeve të periudhës së *"Favorites"*.

Ndoshta nuk është rastësi që **Bong Joon-ho** e arriti kulimin e karrierës me filmin *"Gisaengchung"* (*Paraziti*), një film në gjuhën koreane (regjisori madje i tha publikut në Golden Globes: 'Sapo ta kapërceni pengesën prej një inçi të gjatë të titrave, do të njiheni me kaq shumë filma të mahnitshëm'). Filmat e tij *"Seolgunnyeolcha"* (*Përmes borës*) dhe *"Okja"* (që janë në dy gjuhë, atë angleze dhe koreane – v.j.) i kanë adhuresit e vet (unë nuk jam në mesin e tyre), por është e qartë se i gjithë përqendrimi i tij, saktësia e tij shkoj të fituesi i çmimit Oscar që e dëshmon një zotërim të rrallë të karakterit, të vendit dhe

të klasës ekonomike. Ajo ndjenjë e familjaritetit dhe e njohurisë na del në ekran.

Ndërkohë, vijin lajmet se **Pedro Almodovar** do ta bëjë filmin e tij të parë në anglisht, pas një karriere prej disa dekadash me filmat spanjollë, ndërsa fituesi i Palmës së Artë, **Apichatpong Weerasethakul**, do të shfaq filmin *"Memoria"* (*Kujtesa*) ku luan **Tilda Swinton**. Filmi i fundit duket më pak shqetësues – qasja e prajt e regjisorit tajlandez nuk lidhet shumë me gjuhën – por ka disa arsye pse duhet të shqetësohemi me të parin. Filmat e Almodovar-it janë rrënjësor në mënyrë të pazakontë në fjali, te lokalja, në veçoritë kulturore... e këto gjëra mund të eliminohen.

Me globalizimin vjen një thyerje e barrierave: regjisorët mund t'i lëvizin dhe mbjellin vizionet e tyre kudo që dëshirojnë, por në kinematë e dominuara nga të tjerët, sa herë që regjisorët e mëdhenj do të enden në ato toka, mbase do të ketë humbje të disa kualiteteve, të vizionit të theksuar dhe perspektivës më lartë dhe më individuale.

/Telegrafi/

# Mes synimeve të ndershme dhe kërkesës për famën me çdo kusht

**Nga: Elias Canetti**  
(Fragment nga "Loja e syve: Histori e një jete")  
**Përktheu: Aristidh Ristani**

"...Në Vjenë ishin disa njerëz me të cilët asokohe mbaja marrëdhënie, i takoja shpesh e nuk u shmangesha. Këta qenë ndarë në dy grupe kundërshtarë ndaj njëri-tjetrit. Një palë, që ishin ndoshta nja shtatë a tetë veta, i admiroja për punën e tyre dhe për seriozitetin që tregonin ndaj saj. Qenë njerëz që ndiqnin secili rrugën e vet, që s'pranonin t'ua kthente mendjen askush, që urrenin çdolloj kompromises, që s'u pëlqenin sukseset në kuptimin vulgar të fjalës, që i kishin në Vjenë rrënjët e tyre, megjithëse nganjëherë relativisht të reja, njerëz që zor se mund t'i përfytyroje të jetonin diku gjetkë, por që Vjena s'i kishte korruptuar dot. Këta i admiroja dhe mësoja prej tyre si mund të arrihej diçka pa u tërhequr asnjë centimetër, edhe kur bota s'do t'ia dijë fare.

Ç'është e vërteta, të gjithë ata shpresonin të vlerësoheshin në të gjallë të tyre, por ishin të zgjuar dhe e kuptonin sa e pasigurt që kjo gjë, veçse ishin të vendosur të ngulnin këmbë në arritjen e synimeve të veta, edhe sikur shpotitë që breshëronin pareshur mbi ta të mos u ndaheshin gjer në vdekje. Kjo mënyrë përshkrimi e qëndrimit të tyre mbase mund të ketë një ton disi heroik, dhe ata ishin të gjithë aq seriozë e aq mendjehollë, sa s'do të pranonin ta shihnin veten të paraqitur në dritë të tillë, por megjithatë kishin guxim, kishin edhe një durim që arrinte nganjëherë gjer në cakun e durimit mbinjerëzor. Pastaj vinin të tjerët, ata që ishin tërësisht e kundërta e të parëve, të gatshëm për të bërë gjithçka në emër të parasë, të famës ose të pushtetit. Edhe këta më magjepsnin, por natyrisht në një mënyrë krejt tjetër. Doja t'i njihja thellë, doja të dija ç'ndodhte në shpirtin e tyre, t'i zhbijoj gjer në fijet më të holla, thua se shpëtimi im shpirtëror varej nga aftësia që do të kisha



për t'i kuptuar e për t'i ndier si personazhe të plota. Me këta takohesha po aq shpesh sa edhe me të tjerët, kërshëria që më ngjallnin mund të ishte ndoshta më e madhe, sepse ato gjëra që shihja te këta s'i besojta dot plotësisht dhe prandaj kisha

nevojë gjithnjë e më shumë për t'i vërtetuar. Por, kjo s'do të thotë aspak që bëja ndonjë lëshim kur shoqërohesh me ta, as u vija pas qejfit dhe as përpiquesha të kishin simpati për mua, por ndërkaq nuk arrinin gjithmonë

ta kuptonin menjëherë ç'mendoja në të vërtetë rreth tyre. Edhe në këtë grup bënin pjesë gjashtë a shtatë personazhe kryesore. Por më vështirë se për çdo gjë tjetër e kisha kur detyrohesh të duroja marrëdhëniet midis këtyre dy grupeve."

## Maskat e Shqipërisë që udhëtojnë nëpër botë

Në një studio të qetë në Shqipërinë Veriore, artistët në mënyrë delikate pikturojnë, prarojnë e stolisin dhjetëra mijëra maska veneciane që gazmojnë përreth botës. Ato tashmë kanë nisur të vishen për stinën e karnavalit.

Rreth 50 veta nga stafi punojnë njëhën nga copëzat në fabrikën pranë Liqenit të Shkodrës, e cila eksporton çdo vit deri në 30 mijë maska gjithandej rruzullit. "Në fillim secila (maskë) është mister, duhet të jesh e duruar për ta bërë atë, por mezi pret të shohësh prodhimin përfundimtar", ka shpjeguar Nora Gjonaj, artiste 41 vjeçe që ka punuar në Fabrikën e Maskave Veneciane për dy dekada. Maskat vargëzohen nga mbulesat e thjeshta për sytë deri te copëzat e gjata e me zbukurime për kokën, që kushtojnë nga 20 deri në 1500 euro.

Derisa shumica e maskave janë të përcaktuara për tregun venecian – karnavali i të cilit sivjet është anuluar papritur për shkak të shpërthimit të koron-

avirusit – të tjerat janë nisur në 40 vende të tjera, përfshirë Francën, Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar dhe Australinë.

Kompania merr porosi gjatë vitit edhe nga ata që marrin pjesë në ballo maskaradash, ashtu sikundër edhe prej regjisorëve dhe producentëve të teatrove që kërkojnë kostume.

Nicole Kidman dhe Tom Cruise, fjala vjen, kanë mbajtur dy maska të studios në filmin e vitit 1999 të Stanley Kubrickut "Eyes Wide Shut".

Studioja është themeluar më 1997 nga Edmond Angoni, një shqiptar 64-vjeçar që ka punuar në Itali para se të kthehej në atdhe për të hapur dyqanin e vet.



"Secila maskë ka bukurinë, magjinë dhe misterin e vet", ka thënë ai për AFP-në.

Artistët fillojnë të ndërtojnë një matricë argjile të cilën e mbushin me llaç sa për të krijuar bazën e maskës. Kjo copëz më pas zbutet me letra. Pasojnë një varg hapash të tjerë të për-

piktë, për të cilët Angoni thotë se i ndajnë copëzat nga pjesët e tjera.

"Ne i kushtojmë rëndësi anës artistike të maskës, duke i trajtuar ato me afsh e dashuri posi vepra arti", ka thënë ai.

Vendi i ekspozimit të maskave po bëhet një atraksion në vete

për turistët që mund të lexojnë e qëmtojnë paraqitjen e fytyrave, përfshirë maskat luksoze me gjethe argjendi e ari, pendla, diamante dhe perla. Vizitorët e interesuar mund të blejnë maska apo thjesht të veshin njëhën nga to për një hyrje që kushton tri euro/ AFP/

E rrallë

## Njeriu më i vjetër në botë vdiq në moshën 112 vjeç

Njeriu zyrtarisht më i vjetër në botë vdiq në Japoni. Chitetsu Watanabe u largua nga kjo botë në moshën 112 vjeç, raportuan mediat japoneze. Japonezi Chitetsu Watanabe, i lindur në vitin 1907, kishte marrë certifikatën e Librit të Rekorderve



Guinness me titullin si njeriu më i vjetër në botë në shtëpinë e të moshuarve.

FOTO E DITES



Një burrë me një karrocë ecën gjatë reshjeve të dendura të dëborës në Minsk, Bjellorusi. /Reuters/

E jashtëzakonshme

## 'Hajduti' me pupla merr pjesë në grabitje, bashkëpunëtorët e lënë në baltë

Dy hajdutë të cilët vodhën në një dyqan në Birmingham lanë pas një provë për policinë. Ata morën me vete një rosë dhe, pasi vodhën dyqanin, e lanë atë në vendin e ngjarjes. Këtë e ka bërë me dije policia e West Midlands e cila ishte habitur nga veprimi i



dy burrave. Gjithashtu, ata e postuan në rrjete sociale, duke u shprehur se të qenit polic të përball me situata vërtet të çuditshme. 'Hajduti' me pupla u mor nën kujdestarinë e qendrës së përkujdesjes së kafshëve, e njohur si RSPCA.

### BARSOLETA E DITËS



**Femra: Zemër, blima një picë!**  
**Djali: Me çka?**  
**Femra: Me përshutë.**  
**Djali: Po pyes me çka ta blej, se centin s'e kam.**



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



#### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min  
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj  
**Regjia:** J.J. Abrams



#### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE


Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), **fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Falë Diellit dhe Marsit do të jeni në gjendje të merreni me oferta interesante dhe komplekse të punës që premtojnë shpërblim dhe të ardhura të shkëlqyera.</p>	 <p><b>DEMI</b> Sot do të ndiheni pak të vetmuar dhe të lënë pas dore pavarësisht se në realitet nuk keni arsye pse të ankoheni.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Bëni plane të mëdha për të ardhmen dhe shumë prej tyre janë të realizueshme! Do të jeni të vëmendshëm, veçanërisht të dashur me të dashurin tuaj.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Në dashuri do të duhet të bëni më shumë se zakonisht për ta tërhequr vëmendjen e personit që ju pëlqen më shumë.</p>	 <p><b>LUANI</b> Paratë vijnë dhe shkojnë, kështu që mos mendoni shumë. Marrëdhëniet intime në dashuri po thellohen edhe më shumë.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Me një gjakftohhtësi më të jashtëzakonshme ju do të menaxhoni një situatë mjaft delikate. Në dashuri, kur dëshironi, mund të jeni simpatik.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Ju mund të gjenideni në një situatë të pakëndshme ku do të përpiqeni shumë dhe mund të merrni pak.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Lojërat dhe sfidat e mëdha janë të hapura! Miqësitë e reja dëshmojnë të jenë të rëndësishme si në sektorin social ashtu edhe në sektorin privat.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Hëna premtion gjëra të shkëlqyera dhe rezultate të mëdha në punë, veçanërisht nëse jeni të gatshëm t'i përvishni mëngët dhe të punoni siç duhet.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Kjo ditë mund të sjellë një intuitë fituese. Shumë prej jush do të keni disa fitime të papritura.</p>	 <p><b>UJORI</b> Takoni njerëz të aftë dhe do t'ju ndihmojnë t'i shfrytëzoni burimet tuaja deri më tani të pashfrytëzuara.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Përballë një zgjedhjeje, një vendim të rëndësishëm biznesi, ju do të dini se si të veproni. Në fushën e dashurisë për disa fillon një histori e re e për disa të tjerë një lidhje do të bëhet edhe më serioze.</p>

## Bastisen zyrat e yllit të modës



**A**gjentë amerikane kanë bastisur zyrat e yllit të modës Peter Nygard, në Manhattan, si pjesë e një hetimi për trafikim të qenieve njerëzore. Policia e FBI-së dhe ajo e Nju Jorkut ekzekutuan një urdhër për

bastisje. Kjo bastisje vjen përderisa Nygard, 77-vjeçar, po përballlet me akuza për sulm seksual dhe një padi për trafikim, të paraqitur nga dhjetë gra dhe vajza në fillim të këtij muaji. Ai ka mohuar të gjitha pretendimet për keqbërje.



## Kourtney Kardashian nuk i lë shumë vend imagjinatës

Kourtney Kardashian nuk njihet për pozat ku vë në pah pjesën e prapme të trupit të saj ashtu si motrat e saj Kim, Khloe dhe Kylie, por themeluesja e 'Poosh'-it duket se s'e ka problem që kohë pas kohe t'i shfaqë format trupore. E veshur me një fustan ngjyrë të gjelbër, 40-vjeçarja nuk i ka

lënë shumë vend imagjinatës duke ekspozuar shumë pjesën e pasme të trupit. "Duke përgatitur çajin e pozitivitetit", ka shkruar nëna e tre fëmijëve në 'Instagram', poshtë fotografive ku shihet në kuzhinë duke përgatitur çaj e veshur me fustanin elegant me shumë shkëlqim.

## Paris Hilton: Ndarja me të fejuarin, vendimi më i mirë



**P**aris Hiltoni ka folur në lidhje me përfundimin e fejesës së saj me Chris Zylka, e cila ndodhi në vitin 2018 dhe për arsyen se pse ndodhi. "Ishte vendimi më i mirë që e kam marrë në jetën time. Thjesht mendoj se ai nuk ishte person i

duhur dhe ndiej se jam një grua e jashtëzakonshme dhe se meritoj dikë po aq të mahnitshëm. Thjesht nuk ishte gjë e duhur. Kam punuar tepër shumë dhe nuk e meritoj që t'ia jepja jetën time dikujt. Ata duhet të jenë të përsosur", ka deklaruar Paris.

## Hazz dhe Bllind publikojnë këngën e parë



**S**kenës muzikore në vendin tonë tashmë i janë shtuar edhe dy talentë të rinj. Bëhet fjalë për këngëtarët Hazz dhe Bllind të cilët sapo kanë lansuar projektin e tyre të parë. E titulluar "E kalume", kënga ka marrë pëlqimet e para nga publiku dhe pritet të shndërrohet në hit. Me një

ritëm që të mbetet në mendje dhe një videoklip mjaft të bukur, dy djemtë duken të mahnitshëm në prezantimin e tyre të parë. Kënga është incizuar në studio te Genc Prelvukaj, përderisa për tekstin dhe melodinë janë përkujdesur vetë artistët. Videoklipi është realizuar nga "Blackfish entertainment".

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Apeli vërteton dënimin me burg efektiv për kryetarin e FFK-së, Agim Ademi

**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Gjykata e Apelit e ka vërtetuar dënimin prej nëntë muajsh burg efektiv, që Gjykata e Shkallës së Parë kishte shqiptuar ndaj kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi. Gjithashtu, dënimin me burg efektiv prej një viti Gjykata e Shkallës së Dytë ia ka vërtetuar edhe të akuzuarit tjetër, Muharrem Rama. Kështu, Gjykata e Apelit ka njoftuar se i ka refuzuar të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe avokatëve mbrojtës. "A. A. dhe M. R. janë shpallur fajtorë nga Gjykata e Shkallës së Parë për veprën penale të detyrimit në tentativë, nga neni 267, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1, lidhur me nenin 20 dhe 23 të Kodit Penal të

Kosovës (KPK) dhe janë gjykuar, i pari me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajve, i dyti me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Gjykata e Apelit gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelle esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk është shkelur ligji penal dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Apeli vlerësoj se dënimin i shqiptuar është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së akuzuarve dhe në funksion të qëllimit të përcaktuar me ligj", thuhet në njoftimin e Apelit. Agim Ademi dhe Muharrem Rama akuzohen se gjatë



periudhës kohore 12 korrik - 12 shtator 2012, me qëllim të përfitimit material, e kishin kërcënuar dhe sulmuar Dritëro Kadollin, duke e detyruar të njëjtin të bëjë veprime në dëm të pasurisë së tij, respektivisht të bëjnë përfitim të padrejtë në shumën prej 30.000.00 eurosh, apo një veturë të tipit "BMW X5", e cila më pas pretendohet t'i dorëzohej kryesuesit të Asamblesë Komonale të Prishtinës, Sami Hamitit, duke kryer veprën penale detyrimi në bashkëkryerje. Lidhur me këtë akuzë, Gjykata Themelore në Prishtinë më 5 korrik 2019 i kishte shpallur fajtorë Ademin dhe Ramën për veprën penale detyrim në tentativë. /Betimi për Drejtësi/

## Mbahet seminari për trajnerë

**PRISHTINË, 26 SHKURT (ER)** - Federata e Futbollit të Kosovës në bashkëpunim me Shoqatën e Trajnerëve e ka organizuar seminarin njëditor për trajnerë dhe drejtorë sportivë të klubeve. Në këtë seminar, i cili është mbajtur në hotel "Emerald", ka ligjëruar trajneri i njohur gjerman Thomas von Heesen, derisa atij i ka asistuar ish-futbollisti i mirënjohur shqiptar Fatmir Vata.



Ky seminar u organizua në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë me Federatën e Futbollit të Gjermanisë (DFB) dhe përkrahjen e përfaqësuesit të FFK-së në Gjermani, Fekmi Kongjeli. Në hapje të këtij seminari ishin të pranishëm edhe presidenti Agim Ademi dhe sekretari i

përgjithshëm Eroll Salihu, të cilët falënderuan trajnerin gjerman dhe DFB-në për ndihmën që po i japin FFK-së në çdo segment, derisa të pranishmit dhe mysafirët nga Gjermania i përshëndeti edhe kryetari i Shoqatës së Trajnerëve, Muharrem Sahiti. Gjatë këtij seminar ish-

futbollisti dhe ish-trajneri i Hamburgut dhe Arminia Bielfeldit para trajnerëve kosovarë e ka shpalosur përvojën e tij në klubet ku ka punuar, duke dhënë instruksione të rëndësishme për një punë sa më të suksesshme si trajner. Ai ka folur për rolin e trajnerit, për detyrat që një

trajner duhet t'ua japë futbollistëve, për mënyrën e përgatitjes së ekipit gjatë javës para një ndeshjeje, për përzgjedhjen e lojtarëve, si dhe për sistemin e lojës.

Po ashtu, trajneri gjerman Thomas von Heesen ka bërë edhe një krahasim të futbollit në të kaluarën dhe atij të ditëve të sotme, duke e ndërlidhur me shembuj konkretë nga puna e tij në klubet gjermane, por edhe në vende më të vogla si te Limasol në Qipro.

Këtë seminar me përvojat e tij e ka pasuruar edhe ish-futbollisti i Kombëtares Shqiptare, Fatmir Vata që, po ashtu, ka rrëfyer çaste të rëndësishme nga karriera e tij pikërisht në raportet futbollist-trajner. Sipas Von Heesen, është me rëndësi

që trajneri t'i përshtatet vendit dhe kampionatit ku punon për të pasur sukses. Ai ka thënë se kudo që shkon një trajner duhet ta ketë parasysh që të ketë respekt maksimal për qytetin, për klubin, për tifozët, por edhe për punëtorin më të rëndomtë në stadium, ngase kjo është mënyra e duhur që të arrihet suksesi.

Ai ka folur edhe për raportet trajner-lojtarë, me ç'rast ka inkurajuar trajnerët kosovarë që ta gjejnë mënyrën e duhur që nga futbollistët ta nxjerrin maksimumin. Në fund ai ka kërkuar nga trajnerët që të tregohen të guximshëm, të tregojnë integritet në punën e tyre dhe mos të lejojnë përzjerjen e kryesive të klubeve në punën e tyre.

## Komiteti Ekzekutiv i FFK-së diskutoi për shumë çështje me rëndësi për futbollin e Kosovës

**PRISHTINË, 26 SHKURT (ER)** - Komiteti Ekzekutiv i FFK-së ka mbajtur mbledhjen e radhës nën drejtimin e presidentit Agim Ademi, në të cilën është diskutuar për shumë çështje me rëndësi për futbollin e Kosovës.

KE ka analizuar rrjedhën e garave në Ipko Superligë dhe Ligën e Parë duke konstatuar se deri më tani garat po rrjedhin mirë e me dinamikën e paraparë, hiq disa raste të

kontestuar dhe, së këndejmi, u kërkon komisioneve të FFK-së t'i trajtojnë me seriozitet dhe profesionalizëm dhe t'i marrin masat e duhura.

Po ashtu, Komiteti Ekzekutiv i FFK-së ka analizuar edhe punën e zyrtarëve në ndeshje dhe të komisioneve e ku u tha se zyrtarët në ndeshje, përkatësisht delegatët të jenë në nivelin e detyrave, duke konsideruar se ata përfaqëso-



jnë FFK-në në ndeshje. Ndërkaq, duke analizuar punën e komisioneve konstatoi se ata deri më tash po i

zbatojnë mirë detyrat, por KE u kërkon atyre angazhim edhe më të madh në vazhdim duke pasur parasysh rëndësinë dhe rolin e tyre në mbarëvajtjen e garave. Komiteti Ekzekutiv i FFK-së ka shqyrtuar edhe përgatitjet për ndeshjen e Kombëtares A të femrave kundër Ruisë që do të zhvillohet në Gjermani dhe ka konstatuar se janë marrë të gjithë hapat e duhur për mbarëvajtje të saj.

## David Villa zbulon prapaskena nga e kaluara: 90 për qind isha lojtar i Arsenalit



Ish-ylli i Barcelonës dhe Atletico Madridit, David Villa, ka zbuluar se sa afër ishte për të nënshkruar për Arsenalin në të kaluarën. 38-vjeçari, i cili vari këpucët në gozhdë para disa muajve pas një karriere 19-vjeçare dhe 15 trofeve të fituar, bëri emër në Spanjë para se të luante në ShBA dhe Japoni. Por, mund të ishte shumë ndryshe nëse një lëvizje e propozuar nga


Arsenali do të materializohej pas bisedimeve me menaxherin Arsene Wenger. Ish-sulmuesi, i cili ishte duke luajtur për Barcelonën në atë kohë, ka zbuluar së fundmi këtë histori. “Ne ishim në shumë takime dhe kishte shumë thirrje. Ndieja 90 për qind në atë moment që do të shkoja tek Arsenali dhe Arsene Wenger. Por, në atë çast ne nuk arritëm

në marrëveshje. Atletico Madridi arriti dhe brenda tre ose katër ditësh rregulloi gjithçka. Nuk e di se çfarë do të ndodhte nëse do të nënshkruaja për Arsenalin. Jam shumë i lumtur që kam nënshkruar për Atletico jo vetëm për fitimin e ligës, por për gjithçka. Jam shumë i lumtur që bëra atë zgjedhje”, ka thënë fillimisht Villa për “BBC Sport”.

## Januzaj e pranon: Isha afër largimit nga Sociedadadi në janar, tani jam i qetë dhe në formë

Sulmuesi shqiptar Adnan Januzaj pranon se ai mund të ishte larguar nga Real Sociedadadi muajin e kaluar gjatë afatit kalimtar dimëror. Ish-sulmuesi anësor i Manchester Unitedit tani po shfaq një nga format më të mira të karrierës së tij dhe shënoi në fitoren e fundjavës së kaluar ndaj Valencias. Këto ditë ai është pyetur nga mediat spanjolle rreth formës së tij dhe të ardhmes, duke thënë se ishte afër largimit nga klubi bask. “Ndonjëherë në futboll nuk e dini se çfarë mund të ndodhë. Unë kam qenë të Sociedadadi dhe kam qenë i qetë. Duhet t'i them gjërat ashtu siç janë. Por, ka vendime që nuk varen nga unë, jo vetëm që ishte diçka e imja për të lënë ose jo, gjithashtu e njerëzve që janë

mbi mua. Sigurisht se kishte gjëra, por unë mbeta dhe jam shumë e lumtur. Kolegët e mi më kanë ndihmuar në këtë drejtim. Sepse disa javë më parë tifozët ishin kundër meje. Por, si lojtar nuk më interesojnë. Ata e dinë cilësinë që kam dhe presin shumë më tepër nga unë”, ka thënë Januzaj. Ai ka thënë se tani është në një moment të mirë, posaçërisht fizikisht. “Dhe kjo është mirë, sepse kam edhe paqe në mendje dhe në kokën time. Unë besoj se me cilësinë time duhet të shënoj më shumë gola dhe të bëj më shumë asistime. Jam një lojtar që duhet ta bëj ndryshimin në të gjitha ndeshjet. Më duhet të kem atë. Kjo është ajo që më mungon”, ka deklaruar sulmuesi shqiptar Adnan Januzaj.



## CAS konfirmon apelimin e Man Cityt për dënimin nga UEFA



Gjykata e Arbitrazhit për Sport (CAS) ka konfirmuar se ata kanë regjistruar një apel nga Manchester City, me kampionët e Ligës Premierë që duan ta rrëzojnë vendimin për ndalimin prej dy sezoneve në Ligën e Kampionëve. UEFA e gjeti klubin fajtor për shkeljen e rregullave të Fair Play Financiarit, duke i dorëzuar Cityt një gjobë prej 30 milionë eurosh dhe një pezullim dyvjeçar evropian.

City reagoi shpejt për ta pohuar pafajësinë e tyre dhe u zotua të provojë se UEFA ka gabuar, me një apel të bërë tashmë në CAS. CAS tani ka konfirmuar se ankesa është paraqitur, duke lëshuar një deklaratë zyrtare të mërkurën. “Gjykata e

Arbitrazhit për Sport (CAS) ka regjistruar një ankesë të paraqitur nga klubi i futbollit Manchester City kundër Unionit të Shoqatave të Futbollit Evropian (UEFA)”, thuhet fillimisht në njoftim.

Theksohet se ankesa është drejtuar kundër vendimit të Dhomës Hetuese të Organit të Kontrollit Financiar të UEFA-s të datës 14 shkurt 2020 në të cilin Manchester City u vlerësua se kishte kundërshtuar rregullat e licencimit të klubit dhe rregullat financiare të Fair Play-it dhe u sanksionua me përjashtim nga dy sezone të garave të UEFA-së për të cilat klubi do të kualifikohet dhe u urdhërua të paguajë një gjobë prej 30 milionë eurosh.



Autor: GAZMEND MORINA						RRËNIMI, SHKATËRRIMI	ISH BOKSIERI ..... LIKA	REKRUT NË KOHËN E TURQISË	"T" në mes të dy "E"	NJË NGJYRË	<b>EPOKA E RE</b>	BAKËRPU-NUESI	ZANORE	NXËNËS I SHKOLLËS SË MESME USHTARAKE (shq.)	GRIMCË MOLEKULARE (sh.pashq.)	HIT NGA GRUPI MUZIKOR "NRG BAND"	
BANOR I NJË SHTETI SKANDINAV											ROSAK KLUB FUTBOLLI ARGJENTINAS ... LORENZO						
E MBAROVA, E PËRFUNDOVA (krah.)													KALI I STËRITUR I THAVE				
USHQIM QË SHTROHET E HAHET GJATË PIJES										NISESHTE KËNGËTARJA ..... TAKE							
TEATËR NË PRISHTINË									MALLKIMI NGA KISHA PEZMATIMI I VESHIT								
LLOJ AGRUME											TEZE VLERË E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT					PRES DEGËT E TEPËRTA TË NJË PEME	
INDIUM								VEÇORIA THELBËSORE E NJË DUKURIE SHKRONJË GREKE							BASHKËT. NJË PLANET		
BASHKËT.							KITARË (bised.) LLOJ PEME E VENDEVE TROPIKALE							"URUGUAJ" MALI MË I LARTË NË TURQI (pashq.)			
<b>EPOKA E RE</b>	AKTORJA E FAMSHME SPANJOLLE NË FOTO (shqip.)	NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE	TONELATË	SHALQI	MINDERI I ULËT (vjet.)	FRIKACAKU NËNË (turq.)							LLOJ PAPANALLI BIZNESMEN				
KËPUCË TË POSAÇME PËR TË RRËSHQITUR MBI AKULL							PËREMËR PRONOR POLITIKANI FINLANDEZ ... REHN			ZANORE DY BASHKËTINGËLLORE			NËPËR ARA, ARAVE KËNGËTARI POTOKU (Shq.)				
E EMËROVA NË NJË POZITË										KËNGËTARJA AMERIKANE GWEN FLEGËR							
SHKURTABIQI									KRYELARTË SHUFËR E FORTË DHE E GJATË METALIKE						BASHKËT. MUZIKANTI KRASNIQI		
ELI FARA								NOTË MUZIKORE NJËSIA MONETARE BAZË E SHQIPËRISË		DESPOT QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI (shqip.)						PIANISTJA ALBERTA	
KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE FUTBOLLISTI ..... CANA											MJET PËR SITJE (sh.shq.)						
➔											ISMET SYLEJMANI ANIJATA			"IRLANDA" I NDESH			
EURO - DEPUTETJA GJERMANE DORIS ...							E GJYMTON GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.)						AKTORI FLLOKO KRAHINË NË SHQIPËRI				
BASHKËT.							AMBASADORI I SHBA-së NË SHQIPËRI ALEKSANDËR DY ZANORE		MIRË DE (bised.)	ZULMË MBATHËSE SPORTIVE			BASHKËT. LLOJ VEPRE MUZIKORE		SHKRONJA XIX LAKESË (sh.pashq.)		
QË KA TË BËJË ME FSHATARËSINË								ANTON PASHKU FUTBOLLISTI CORDOBA (INTER)			FEUDALI QË I NËNSHTROHEJ MBRETIT BASHKËT.						
➔								I PËRZJEVA KËNGËTAR I FAMSHËM AMERIKAN								LUFTËTARI GJERGJ ..... ALIA	
KATRORE BASHKËT.							AFROJ (bised.) DY BASHKËTINGËLLORE				TITAN, NITROGJEN OSMAN (perkdh.)			"KENIA" DEPARTMENT INDUSTRIAL RELATIONS			
<b>EPOKA E RE</b>	BASHKËT. SHKRONJA TË NJËJTA		AKTORJA ..... KURTI VARIOLE					KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK IKER KASILLAS					FUTBOLLISTI FRANCEZ ... RAMI (VALENCIA) DY BASHKËTINGËLLORE				
KAFSHË SHTËPIAKE PËRTYPËSE E IMËT								AKTORJA ITALIANE BELLUÇI ZANORE			QYTET NË KOSOVË ZANORE						
KLUB FUTBOLLI NË KOSOVË								NANTES	ISH PORTIERI SPANJOLL SANTIAGO (VALENCIA)								

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

**Kërkoj kujdestare për vajzën 7 muajshe në Prishtinë.**  
Për informata në tel: 044-444-009

► Tesmi Maxhuni B.I. shpall të pavlefshëm nr. e biznesit 71213161

► Kaltrina Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Ali Sokoli" Prishtinë.

► Agon Malaj shpall të pavlefshme diplomën e SHMP "Qendra e Kompetencës" Skenderaj.

► Valmir Gucati, shpall të pavlefshme diplomën e SHMP "Qendra e Kompetencës" Skenderaj.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

